



**KONRAD
ADENAUER
STIFTUNG**

MANUAL PËR LIGJIN E BASHKËSIVE FETARE DHE LIRINË E FESË NË MAQEDONINË E VERIUT

ALEKSANDAR SPASENOVSKI



MANUAL PËR LIGJIN E BASHKËSIVE FETARE DHE LIRINË E FESË NË MAQEDONINË E VERIUT

ALEKSANDAR SPASENOVSKI

Shkup, 2021

IMPRESUM

Titulli:

Manual për Ligjin e Bashkësive Fetare dhe Lirinë e Fesë në Maqedoninë e Veriut

Autor:

Aleksandar Spasenovski, docent në Fakultetin Juridik "Justiniani i Parë" në Shkup, Universiteti "Shën Qirili dhe Metodi" në Shkup

Recensentë:

Vasko Naumovski, profesor asistent në Fakultetin Juridik "Justiniani i Parë" në Shkup, Universiteti "Shën Qirili dhe Metodi" në Shkup

Vladimir Bozinovski, profesor asistent në Fakultetin Juridik "Justiniani i Parë" në Shkup, Universiteti "Shën Qirili dhe Metodi" në Shkup

Botues:

Konrad-Adenauer-Stiftung e.V.

Klingelhöferstr. 23

10785 Berlin

Gjermani

Tel: +49 0 30 269 96 0

Fax: +49 30 269 96 3217

Website: www.kas.de

Fondacioni "Konrad Adenauer"

Porgrami për Sundimin e së Drejtës në Europën Juglindore

Strada Franzelarilor, 5, 020785 Bukuresht

Rumani

Telefoni: (+40) (0) 21 302 02 63

Faksi: (+40) (0) 21 323 31 27

office.rspsoe@kas.de

www.kas.de/rspsoe

Fakultetin Juridik "Justiniani i Parë" – Shkup

Goce Dellçev 9b, 1000 Shkup

Republika e Maqedonisë së Veriut

Telefoni: (+389) (0) 2 311 72 44

Faksi: (+389) (0) 2 322 75 49

www.pf.ukim.edu.mk

Koordinimi:

Hartmut Rank, Udhëheqës i Programit për Sundimin e së Drejtës në Europën Juglindore të Fondacionit Konrad Adenauer

Redaktor:

Tanja Karakamisheva - Jovanovska, profesoreshë e rregullt në Fakultetin Juridik "Justiniani i Parë" në Shkup, Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup

Përktheu:

Ismet Osmani

Përgatitjen kompjuterike dhe shtypjen:

Shtypshkronja Vinsent Grafika
Bllagoja Stefkovski 16, 1000 Shkup
Republika e Maqedonisë së Veriut
Telefoni / Faksi: (+389) (0) 2 270 04 55
info@vinsentgrafika.mk
www.vinsentgrafika.mk

Tirazhi:

150 kopje

Libri mund të shkarkohet falas në:

<http://www.kas.de/rlpsee/>

Vërejtje:

Ky botim jepet falas si pjesë e Programit për Sundimin e së Drejtës në Europën Juglindore të Fondacionit Konrad Adenauer.

Përgjegjësia e përmbajtjes së këtij botimi është ekskluzivisht e autorëve.

PËRMBAJTJA

HYRJE	11
<hr/>	
1. KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT DHE PARIMI I SHEKULLARIZMIT	21
<hr/>	
1.1 KONCEPTET TJERA KUSHTETUESE.....	26
2. LIGJI PËR STATUSIN JURIDIK TË KISHËS, BASHKËSISË FETARE DHE GRUPIT RELIGJIOZ	31
<hr/>	
2.1 KONCEPTET TJERA LIGJORE.....	38
2.2 AKTVENDIMET DHE VENDIMET E GJYKATËS KUSHTETUESE.....	40
3. AKTET TJERA ME TË CILAT PËRCAKTOHET STATUSI I RELIGJIONEVE DHE LIRIA E FESË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT	41
<hr/>	
3.1. DËSHMIMI I PËRKATËSISË FETARE.....	43
3.2. KTHIMI I PRONËS – DENACIONALIZIMI.....	46
3.3. MBROJTJA NGA DISKRIMINIMI FETAR.....	47
3.4. E DREJTA E KUNDËRSHTIMIT TË NDËREGJEGJES.....	53
3.5. EDUKIMI FETAR.....	57
3.6. BEKIMI FETAR NË SHKOLLAT SHTETËRORE.....	61
3.7. STATUSI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË TË ORGANIZATAVE FETARE	62
3.8. KREMTIMI SHTETËROR I FESTAVE FETARE.....	65
3.9. STATUSI I AKTEVE TË ORGANIZATAVE FETARE.....	69
3.10. MBËSHTETJA SHTETËRORE NË PUNËN E AUTOQEFALES SË KISHËS ORTODOKSE MAQEDONASE.....	71

4. KORNIZA INSTITUCIONALE	75
<hr/>	
4.1. KOMISIONI PËR MARRËDHËNIE ME BASHKËSITË FETARE DHE GRUPET RELIGJIOZE	77
4.2. GJYKATA KUSHTETUESE.....	79
4.3. KOMISIONI I PËRHERSHËM ANKETUES PËR MBROJTJEN DHE LIRINË E TË DREJTAVE TË QYTETARIT	80
4.4. AVOKATI I POPULLIT.....	81
4.5. KOMISIONI PËR PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI.....	82
SHQYRTIME PËRFUNDIMTARE	83
<hr/>	
LITERATURA E SHFRYTËZUAR	87
<hr/>	
AKTET	90
<hr/>	

PARATHËNIA

PARATHËNIA

Mbrojtja dhe garantimi i lirisë së besimit fetar, e drejta për të mos u lidhur me ndonjë fe ose besim, dhe mundësia që komunitetet fetare të praktikojnë fenë në mënyrë të papenguar janë elemente themelore të së drejtës për lirinë e fesë në kushtetutat demokratike. Liria fetare është një nga të drejtat më themelore të njeriut, që, për t'u realizuar, kërkon ndarjen e shtetit nga institucionet fetare. Shkalla në të cilën liria fetare është e mbrojtur dhe e garantuar gjithashtu zbulon gjithmonë diçka rreth karakterit të shoqërisë dhe shtetit. Me fjalë të tjera: Nëse liria fetare në të gjitha aspektet e saj nuk zbatohet dhe garantohet në një komunitet ose shtet, nënkupton mosrespektimin e të drejtave të njeriut dhe është mungesë e vlerave kushtetuese.

Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut ka qenë gjithmonë një nga misionet thelbësore të Fondacionit Konrad Adenauer, i cili është një fondacion demokratik i krishterë gjerman. Në rajonin e Ballkanit të mbërthyer nga krizat, Programi për Sundimin e Ligjit i Fondacionit Konrad Adenauer për Evropën Jug-Lindore i ka vendosur vetes qëllimin e komunikimit të vazhdueshëm, të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për të drejtat e njeriut si pjesë integrale e Kushtetutës së një shteti. Feja është një çështje gjithnjë e pranishme dhe e ndjeshme në shoqëritë dhe shtetet post-socialiste multikonfesionale në Ballkan.

Si manual, ky botim jep një kontribut të hollësishëm dhe të vlefshëm për sqarimin dhe edukimin rreth lirisë fetare dhe bashkësive fetare në Maqedoninë e Veriut. Ai jo vetëm tregon se si është strukturuar marrëdhënia midis shtetit dhe fesë dhe cilat dispozita ligjore (kushtetuese) ekzistojnë për të mbrojtur lirinë fetare dhe komunitetet fetare, por gjithashtu edhe mënyrën se si këto dispozita interpretohen nga gjykatat dhe në fund të fundit zbatohen nga institucionet shtetërore. Analizat e bëra në këtë manual mbi kuptimin e fesë në Maqedoninë e Veriut shërbejnë për të cilësuar shtetin e ri të Maqedonisë së Veriut për garantimin e së drejtës së lirisë fetare. Ky botim do të jetë një shtysë për të stimuluar dialogun ndërfaqetar jo vetëm në RMV, por edhe më gjerë. Përfundimisht, komunikimi dhe toleranca shkojnë krahas krahas dhe janë parakusht për garantimin e lirisë fetare si një e drejtë jashtëzakonisht e rëndësishme e njeriut.

Falënderojmë Aleksandar Spasenovskin nga Fakulteti Juridik "Iustinianus Prima" në Universitetin "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup për bashkëpunimin intensiv dhe produktiv dhe shpresojmë që të gjithë lexuesit e interesuar të kenë një lexim të pasur.

Hartmut Rank, LL.M

Udhëheqësi i programit të
KAS për Sundimin e
Ligjit për Evropën Juglindor

Stanislav Splavnic, LL.M

Koordinator i projektit Programi
i KAS për Sundimin e
Ligjit për Evropën Juglindore

HYRJE

HYRJE

Ndarja e Republikës Socialiste të Maqedonisë me Republikën Socialiste Federative të Jugosllavisë¹ ndodhi në dritën e ndërrimeve të mëdha tektonike në ish-shtetet evropiane socialiste/komuniste në dekadat e fundit të shekullit të 20-të², si rezultat i një sërë rrethanash të brendshme politike, ekonomike dhe sociale.

Në lidhje me RSFJ-në, këto procese nxorën në sipërfaqe disa mite konservatore të kombeve konstituive, të cilat, në procesin e tranzicionit të sistemeve kushtetuese dhe politike, vendosën përparësi të reja kryesore në bazë të këtyre premisave: shtete kombëtare me rend demokratik, sipërmarrësi të lirë dhe konkurruese, ekonomi tregu, si dhe pluralizmin politik dhe social në përputhje me standardet e demokracive të zhvilluara të Evropës Perëndimore³.

Duke pasur parasysh konceptet e kundërta kushtetuese, atë që po prishej dhe atë që do të krijohesh, dhe nën presionin e trendëve kryesore globale, filloi shembja me dhunë e Jugosllavisë, e cila rezultoi në formimin e Republikës së sotme të Maqedonia

-
- 1 Rënien e RSFJ-së e karakterizojnë një varg konfliktesh ushtarake, të cilat zhvillohen në territorin e këtij shteti përveç Maqedonisë, e cila e fitoi pavarësinë e saj në mënyrë paqësore. Luftërat u karakterizuan me konflikte të ashpra etnike midis Armatës Popullore Jugosllave dhe sllovenëve në Slloveni; midis kroatëve dhe serbëve në Kroaci; midis serbëve, kroatëve dhe boshnjakëve në Bosnje dhe Hercegovinë, dhe midis serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë. Konfliktet e përgjakshme që rezultuan me shpërbërjen e Jugosllavisë Federale përfunduan me nënshkrimin e Marrëveshjeve të Paqes në Dejton më 1995. Që nga shpërbërja e këtij vendi, në fillim u krijuan 5 shtete të reja, përkatësisht Sllovenia, Kroacia, Republika e Maqedonisë, Bosnja dhe Hercegovina dhe Republika Federative e Jugosllavisë (e cila përfshinte Serbinë dhe Malin e Zi). Më 21 maj 2006, si rezultat i referendumit të zhvilluar, Mali i Zi u bë shtet i pavarur, dhe kështu edhe Serbia. Ndërsa, më 17 shkurt 2008, deputetët e Parlamentit të Kosovës miratuan Deklaratën e Pavarësisë. Luftërat në Jugosllavi konsiderohen si një nga konfliktet më të ashpra të armatosura në Kontinentin e Evropës që nga fundi i Luftës së Dytë Botërore, duke bërë që KB të themelojnë Gjykatën Ndërkombëtare të Krimeve për ish-Jugosllavinë, e cila ka nisur procedura për krime të luftës kundër një numri të madh të pjesëmarrësve në këto konflikte (Shih: Petar Radan, *Break-up of Yugoslavia and International Law*, Routledge, 21.9.2001; Henry H. Perritt, *The road to independence for Kosovo: a chronicle of the Ahtisaari plan*, Cambridge University Press, Cambridge, 2010).
 - 2 Si rezultat i kryengritjeve popullore nëpër vendet e Evropës Lindore, filloi procesi i rrëzimit të komunizmit. Ngjarjet filluan në Poloni në vitin 1989, vazhduan në Hungari, Gjermaninë Lindore, Bullgari, Çekoslllovakia dhe Rumani. Bashkimi Sovjetik u shkatërrua më 1991 si rezultat i vendimit të Federatës Ruse dhe 14 kombeve të tjera për të shpallur pavarësinë e tyre. Midis viteve 1990 dhe 1992, ky sistem i pushtetit shtetëror u shemb edhe në Shqipëri, si dhe në Jugosllavinë Federative. Këto procese ndikuan edhe në vendet e tjera socialiste jashtë kontinentit evropian, si p.sh. në Kamboxhia, Etiopi dhe Mongoli, të cilat gjithashtu e flakën këtë sistem të rregullimit shtetëror. (Shih: Bartlomiej Kaminski, *The Collapse Of State Socialism*, Princeton University Press, Princeton, New Jersey, 1991).
 - 3 Shih: Carole Rogel, *The Breakup of Yugoslavia and its Aftermath*, Greenwood Press, 2004.

e Veriut⁴ si shtet sovran, i pavarur dhe demokratik, i cili premtoi respektimin e plotë të parimeve të përbashkëta demokratike të së drejtës ndërkombëtare siç përmbahen në aktet e OKB-së⁵, dhe dokumentet e organizatave të tjera ndërkombëtare, europiane dhe rajonale.

Duke vendosur një rend të ri kushtetues, ligjor dhe politik, Republika e Maqedonisë së Veriut duhej t'u përgjigjej sfidave të kohës së re.

Sistemi i krijuar me miratimin e Kushtetutës më 17 nëntor 1991⁶, e projektoi Maqedoninë e Veriut si shtet qytetar dhe demokratik, me një pozicion kryesor të parimit të sundimit të ligjit dhe garantimin e të drejtave të njeriut, lirive qytetare dhe barazisë kombëtare⁷.

Lidhur me çështjen e marrëdhënieve me organizatat fetare dhe garantimin e lirive dhe të drejtave fetare, Republika e Maqedonisë së Veriut ndërtoi një model të bazuar në:

-
- 4 Procesi i fitimit të pavarësisë së Republikës së Maqedonisë përmes ndarjes nga RSFJ e atëhershme filloi në vitin 1990. Më 20 Shtator të vitit 1990, Kuvendi i RSM-së miratoi 25 amendamente të Kushtetutës, me të cilët u bënë ndryshimet e para në sistemin kushtetues-juridik (Vendimi për shpalljen e amendamenteve LVII - LXXXI të Kushtetutës së Republikës Socialiste të Maqedonisë, Amendamente të Kushtetutës së Republikës Socialiste të Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste të Maqedonisë, Viti: XLVI, Nr. 28, Shkup, 21.9.1990, f. 506-511.). Më 24 shtator 1990, Kryetari i Dhomës Legjislative i shpalli zgjedhjet e para demokratike shumëpartiake, të mbajtura më 11 nëntor të po këtij viti, kurse Kuvendi i Maqedonisë në këtë përbërje u konstituua më 8 janar të vitit 1991. Më tej, më 27 janar të vitit 1991, deputetët zgjedhën presidentin e parë të Republikës, Kiro Gligorov, dhe më 20 mars të vitit 1991 u zgjodh qeveria e parë eksperte e kryesuar nga Nikolla Klusevi. Ndërkohë, më 25 janar të vitit 1991, përfaqësuesit e qytetarëve në Kuvend miratuan Deklaratën e Sovranitetit të Maqedonisë së Veriut (Deklarata e Sovranitetit të Republikës Socialiste të Maqedonisë, Kuvendi i Republikës Socialiste të Maqedonisë, nr. 08-220-1). Më tej, më 7 qershor të vitit 1991, u miratua amendamenti kushtetues LXXXII me të cilin në emrin RSM u hoq termi "socialist" (Vendimi për shpalljen e amendamenteve LXXXII deri në LXXXV të Kushtetutës së Republikës Socialiste të Maqedonisë, Amendamente të Kushtetutës së Republikës Socialiste të Maqedonisë, Gazeta e Republikës së Maqedonisë, Viti: XLVII, Nr. 27, Shkup, 11 qershor 1991, f.: 357). Në lidhje me këtë, më 7 maj të vitit 1991, Presidenti i Republikës së Maqedonisë para deputetëve bëri propozimin për miratimin e kushtetutës së re demokratike, e cila u miratua më 17 nëntor të vitit 1991, të cilës i parapriu Referendumi për Pavarësi i organizuar më 8 shtator të vitit 1991, dhe Deklarata me rastin e shprehjes së vullnetit të qytetarëve me plebishit për shtet sovran dhe të pavarur maqedonas - Maqedonisë, që u miratua në seancën e Kuvendit më 17 shtator të vitit 1991 (Deklaratë me rastin e shprehjes së vullnetit të qytetarëve me plebishit për shtet sovran dhe të pavarur maqedonas - Maqedonisë, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë nr. 08-3786, 17.9.1991). Përfundimisht, më 19 dhjetor 1991, me miratimin e Deklaratës së Njohjes Ndërkombëtare të Republikës së Maqedonisë, filloi procesi i njohjes ndërkombëtare të shtetit tashmë të themeluar maqedonas (Deklarata e Njohjes Ndërkombëtare të Republikës së Maqedonisë, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, nr. 08-5099, 19.12. 1991).
 - 5 Shih: *Brad K. Blitz, War and change in the Balkans: nationalism, conflict and cooperation, kreu i 9 Andrew Rosos, Disintegration of Yugoslavia: Macedonia's Independence and Stability in the Balkans, Cambridge University Press, Cambridge, 2006, (f. 110-118). Deklaratë me rastin e shprehjes së vullnetit të qytetarëve me plebishit për shtet sovran dhe të pavarur maqedonas - Maqedonisë, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë nr. 08-3786, 17.9.1991.*
 - 6 *Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Viti: XLVII, nr. 52, Shkup, 1991, (f. 805-815).*
 - 7 Shih: Gerhard Robbers, *Encyclopedia of World Constitutions*, Igor Spirovski (author), Macedonia, VB Hermitage, (f. 551-555).

1. standardet ndërkombëtare euro-perëndimore;
2. traditat e popullsisë shumicë që praktikojnë versionin ortodoks të krishterimit, dhe
3. pasqyra aktuale fetare.

Sfida e modelit maqedonas të marrëdhënieve me organizatat fetare, si dhe garancitë e lirive dhe të drejtave fetare, siç do të tregojë realiteti, qëndron në guximin e balancimit të tre faktorëve të përmendur.

Standardet ndërkombëtare euro-perëndimore të përfshira në sistemin kushtetues-juridik të Maqedonisë së Veriut janë, në fakt, vlera që burojnë nga teoria e të drejtave natyrore të shekujve 17 dhe 18, renesancës⁸, civilizimit⁹ dhe reformës protestante, të cilat janë pjesë e historisë dhe praktikës së Europës Perëndimore dhe Amerikës së Veriut¹⁰.

Sipas këtyre ideve, siç vërehet në pjesën e parë të punimit, të drejtat dhe liritë e njeriut shihen si një version i shekullarizuar i etikës hebraike-krishtere, ndërsa çështja e marrëdhënies midis shtetit dhe organizatave fetare shikohet përmes prizmit të modelit të tyre të ndarjes¹¹.

Në përputhje me këto vlera dhe ide, më 1776 u miratua Deklarata Amerikane e Pavarësisë¹², më 1789 Franca Revolucionare miratoi Deklaratën e të Drejtave të Njeriut dhe Qytetarit¹³, dhe më 1791 u miratua Karta Amerikane e të Drejtave¹⁴. Këto dokumente konsiderohen si gurthemeli i sistemit ekzistues të të drejtave dhe lirive të njeriut, në të cilat liritë dhe të drejtat fetare konsiderohen një segment i pashmangshëm.

Me zhvillimin e kushtetutës moderne, këto premisa dhe vlera gjetën më vonë vendin e tyre në kushtetutat e vendeve të Europës Perëndimore, si dhe në shumë dokumente të tjera ndërkombëtare, në veçanti në Deklaratën Universale të të

8 Shih: Stathis N. Kalyvas, *Religion and Democratization: Belgium and Algeria*, Estudio/Working Paper 107, 1997 и Sabine C. Carey et.al., *The Politics of Human Rights: The Quest for Dignity*, Cambridge University Press, Cambridge, 2010, (f. 16).

9 Shih: Martin Fitzpatrick et al., *The Enlightenment World*, Routledge, New York, 2004.

10 Shih: Stathis N. Kalyvas, *Religion and Democratization: Belgium and Algeria*, Estudio/Working Paper 107, 1997, and Sabine C. Carey et.al., *The Politics of Human Rights: The Quest for Dignity*, Cambridge University Press, Cambridge, 2010 (p. 16).

11 Shih: Micheline Ishay, *The History of Human Rights: From Ancient Times to the Globalization Era*, University of California Press, 2008, (f. 64).

12 *Declaration of Independence*, (archives.gov), 7.3.2018.

13 *Declaration of the Rights of Man and of the Citizen*, (hrcr.org), 7.3.2018.

14 *Bill of rights*, (archives.gov), 7.3.2018.

Drejta të Njeriut të OKB-së të vitit 1948¹⁵, si dhe në dokumentet e Këshillit të Europës, në NATO dhe ish Komunitetet Europiane, dmth. Bashkimin e sotëm European (BE-në).

Në dokumentet e këtyre organizatave në mënyrë plotësuese janë shtjelluar çështjet që janë marrë në legjislaturat e shteteve nacionale, por edhe në disa konventa dhe traktate të tjera plotësuese¹⁶.

Në përgjithësi, mund të thuhet se modeli maqedonas i shekullarizmit ka përvojë nga **traditat e versionit ortodoks të krishterimit që janë më afër popullsisë shumicë në vend, si dhe nga ekumeni tjetër ortodoks i cili si model të shtetit ideal e merr Perandorinë Bizantine**¹⁷.

Modeli bizantin mbështetet në një sistem **uniteti midis kishës dhe autoritetit shtetëror**¹⁸.

Në autoritetin e perandorit që sundoi me Perandorinë qenë përqendruar edhe pushteti laik dhe shpirtëror, ose pushteti kishtar¹⁹. Në këtë model, Kisha Ortodokse nuk e përmbushi qëllimin e saj parësor vetëm në bazë të veprimtarive të bazuara në premisat shpirtërore, por edhe në funksion të shtetit që si pjesë përbërëse ishte edhe ajo²⁰.

Ekzistonte dhe vllente rregulla, që, nëse kisha nuk ishte plotësisht e lidhur me shtetin, një shtet i tillë nuk mund të konsiderohej plotësisht funksional. Prandaj, ndër të tjera, edhe juridiksioni i Kishës Ortodokse ishte i lidhur me kufij konkret shtetëror dhe nëse do të vendosej të zgjerohen kufijtë e shtetit, gjithashtu pritej të zgjerohej edhe juridiksioni i kishës.²¹

Dhe anasjelltas.

Nëse do të zgjerohej juridiksioni i kishës, atëherë do të ishte e zakonshme të dalin në sipërfaqe edhe tendencat politike për ndryshimin e kufijve shtetërorë²².

15 Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut,(un.org), 7.3.2018.

16 Shih: Blandine Chelini-Pont, *Religion and Society in Europe*, Conference: "Law and Religion in Transitional Societies", Norway, 2006.

17 Shih: John Meyendorff, *The Byzantine Legacy in the Orthodox Church*, St Vladimir's Seminary Press, Crestwood-New York, 1982.

18 Pedro Ramet, *Eastern Christianity and Politics in the Twentieth Century*, Duke University Press, 1988, f. 37-58.

19 Pedro Ramet, *Eastern Christianity and Politics in the Twentieth Century*, op.cit., f. 40.

20 Shih: Mile Bogović, *Država i crkva u srpskom pravoslavlju*, Centar za politikološka istraživanja (cpi.hr), 7.3.2018.

21 Shih: Mile Bogović, *Država i crkva u srpskom pravoslavlju*, op.cit.

22 Ibid.

Gjatë periudhës së rënies së popujve ortodoksë nën robëri, kisha kishte mision për të “mbajtur zjarrin” me qëllim të rivendosjes së shtetësisë në territoret që udhëhiqeshin nën juridiksionin e saj.

Lidhur me çështjen e lirisë dhe të drejtave fetare, Perandoria Bizantine, e cila ishte model ortodoks i shtetit, i njohu të krishterët ortodoksë si element konstituiv në shtetësinë e vet.

Ndërkaq, kushti themelor që një person të fitojë statusin e shtetit dhe kapacitet të plotë në Bizant ishte që të jesh i krishterë ortodoks²³.

Në dallim nga standardet e sotme ndërkombëtare, të cilat u zhvilluan nën ndikimin e fuqishëm të traditës katolike-protestante, ku që nga fillimi për shkak të konceptit të ndarjes së autoritetit shpirtëror nga ai laik që hapur rruga e pluralizmit, Lindja Ortodokse Evropiane mbështetej në unitetin e autoritetit të kishës dhe shekullarizimit, domethënë, ajo karakterizohej më shumë nga monoliteti shtet-kishë dhe kolektivizmi²⁴.

Republika e Maqedonisë së Veriut nuk ka një **shoqëri homogjene fetare**.

Përveç pjesëtarëve të variantit ortodoks të krishterimit, në shoqërinë maqedonase ekziston edhe një numër konfesionesh të tjera, siç janë konfisioni islam, konfisioni i krishterë – katolik, konfisioni i krishterë - protestant, hebraik etj²⁵.

Realiteti fetar dhe religjioz pluralist në Maqedoninë e Veriut ka formuar më tej modelin e tij të marrëdhënieve me organizatat fetare, si dhe karakterin e lirisë dhe të drejtave fetare në vend.

Në frymën e standardeve euro-perëndimore dhe ndërkombëtare, traditat historike të krishterimit ortodoks, dhe në përputhje me parimet e pluralizmit fetar, shteti ka dhënë disa garanci për praktikën dhe kultivimin e konfesioneve të tjera të pakicave.

Postulatet praktike në marrëdhëniet me organizatat fetare, si dhe lirinë e fesë, Maqedonia e Veriut i ka vendosur në bazë të:

1. trashëgimisë shpirtërore euro-perëndimore e cila thotë se pushteti shtetëror është i ndarë nga organizatat fetare, dhe se parimi i shekullarizmit pranohet si parim i mosndërhyrjes së institucioneve shtetërore në kompetencat e

23 Shih: Philip Schaff, David Schley Schaff, *History of the Christian church*, Charles Scribner's Sons, New York, 1910.

24 Mile Bogović, *Država i crkva u srpskom pravoslavlju*, op.cit., f. 89.

25 Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë dhe amvisërive në vitin 2001, në Republikën e Maqedonisë së Veriut 64, 7% e popullsisë është deklaruar se i takon fesë ortodokse, 33,3% fesë islame, 0,34% fesë katolike, ndërsa 1,5% feve të tjera (stat.gov.mk), 7.3.2018.

- organizatave fetare, dhe anasjelltas. Shekullarizmi shprehet edhe përmes ndalimit kushtetues për përfshirjen dhe ndërhyrjen thelbësore të organizatave dhe komuniteteve fetare në çështje që janë në kompetencën e shtetit;
2. garancive të siguruara për ushtrimin e lirive dhe të drejtave fetare të qytetarëve janë bazuar në standardet universale dhe euro-perëndimore;
 3. traditave të variantit ortodoks të krishterimit në dritën e trashëgimisë së Perandorisë Bizantine. Duhet theksuar se Kisha Ortodokse në Maqedoninë e Veriut, si dhe trashëgimia e saj historike dhe shpirtërore, kanë një vend parësor në sistem;
 4. karakterit heterogjen të peizazhit fetar në shtetin që po ndërtohet në bazë të sistemit ekzistues të garancive për ekzistencën dhe funksionimin e lirë të Bashkësisë Islame, Kishës Katolike, kishave protestante, Komunitetit Hebre dhe organizatave të tjera më të vogla fetare.

Që nga pavarësia e saj deri më sot, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, shtyllat ideologjike-politike që kanë përcaktuar modelin maqedonas të shekullarizmit nuk kanë funksionuar gjithmonë në harmoni dhe kohezion të plotë. Ky përfundim mund të nxirret nga karakteri i dispozitave juridike të miratuara në këtë fushë, të cilat do të diskutohen më poshtë në tekst.

Ndërkaq, siç do të vërehet, **karakteri i zgjidhjeve juridike në masë të madhe kushtëzohet nga pozicionet ideologjike ose matricat e veprimit të partive qeverisëse në vend.**

Kështu, **partitë, thënë kushtimisht, të majta në shtet, angazhohen për një formë më të theksuar të shekullarizmit, sipas të cilit shteti duhet të zhvillojë vetëm një qëndrim të përgjithshëm ndaj të gjitha organizatave dhe komuniteteve fetare, ndërsa në dallim nga to, partitë, thënë kushtimisht, të djathta në shtet synojnë etbalimin e një shekullarizmi më pak të shprehur, me të cilin, në kuadër të vendosjes së qëndrimit ndaj organizatave fetare, kërkojnë të ngritin statusin e Kishës Ortodokse Maqedonase.**

Nga ana tjetër, partitë e bashkësive etnike, në kuadër të konceptit të përcaktuar kushtetues të ndarjes së shtetit nga organizatat fetare, theksojnë rëndësinë dhe rolin, para së gjithash, të Bashkësisë Fetare Islame në kushtet kur kërkohet që një status i tillë t'i jepet edhe KOM-it.

Ky fakt të shpjegë në përfundimin se në Republikën e Maqedonisë së Veriut ende nuk ka unanimitet në lidhje me çështjen e gjetjes së balancës së përsosur

midis tre faktorëve që përcaktojnë modelin shtetëror të marrëdhënieve me organizatat fetare dhe në këtë kuptim lirinë e fesë.

Në vazhdim, në përputhje me qëllimet e këtij punimi, është dhënë edhe një pasqyrë e karakteristikave më të rëndësishme të sistemit kushtetues dhe juridik të Republikës së Maqedonisë së Veriut në lidhje me statusin e organizatave fetare, si dhe çështjen e lirisë së fesë.

Para së gjithash, do t'i bëhet një vështrim kornizës kushtetuese-juridike dhe kornizës ligjore në vend në lidhje me organet dhe institucionet të cilat në fushëveprimin e tyre merren me këtë temë jashtëzakonisht të rëndësishme.



**KUSHTETUTA E RMV-SË,
STATUSI I RELIGJIONEVE
DHE LIRIA E FESË**

1. KUSHTETUTA E RMV-SË, STATUSI I RELIGJIONEVE DHE LIRIA E FESË

Kushtetuta e RMV-së²⁶, e miratuar më 17 nëntor 1991, përcakton kornizën themelore brenda së cilës lëviz dhe shqyrtohen marrëdhëniet e shtetit me organizatat fetare, si dhe garancitë e lirisë së fesë. Gjatë periudhës së miratimit të Kushtetutës, si dhe gjatë ndryshimeve të saj të mëvonshme, u bënë shumë propozime se si të rregullohen këto çështje në mënyrën më të mirë të mundshme.

Nënshkrimi i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit më 2001 mundësoi një varg ndryshimesh në Kushtetutë, të cilat nxitën ndryshime të mëtejshme në karakterin e modelit maqedonas të shekullarizmit.

Teksti i parë i Kushtetutës, para nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, përcaktonte marrëdhëniet midis shtetit dhe organizatave fetare, si dhe garancitë e lirisë fetare me dispozitat që kanë të bëjnë me këto çështje:

1. Barazia dhe liria e përcaktuar në nenin 9 paragrafi 1, si dhe nenin 16 paragrafi 1 të Kushtetutës

Derisa me nenin 1 garantohet barazia e qytetarëve në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës, origjinës kombëtare dhe sociale, gjendja pronësore dhe shoqërore, si dhe në bazë të bindjes politike dhe fetare, me nenin 16 paragrafi 1 të Kushtetutës, shteti garanton lirinë e besimit, ndërgjegjen, mendimin dhe shprehjen publike të mendimit, veçanërisht në segmentin e bindjes fetare dhe manifestimin e bindjes së tillë në sistem.

2. Liria e fesë e përcaktuar në nenin 19 të Kushtetutës së RMV-së

Sipas këtij neni, shteti garanton lirinë e fesë (paragrafi 1), dhe ju lejon qytetarëve të shprehin besimin e tyre lirshëm, individualisht ose në bashkësi me të tjerët (paragrafi 2).

26 *Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: XLVII, nr.: 52, op.cit.

Mbi bazën e këtyre dy qëndrimeve të përgjithshme, Kushtetuta hynë më tej në realitetin e jetës fetare, duke parashikuar që KOM-i, si dhe komunitetet e tjera fetare dhe grupet religjioze, janë të ndara nga shteti (paragrafi 3) dhe se, sipas radhitjes emërore, konstatohet se fetë e lartpërmendura janë të lira të themelojnë shkolla fetare, institucione sociale dhe bamirëse në një procedurë të përcaktuar me ligj (paragrafi 4).

Në vitin 2001, me ndryshimin e Kushtetutës, si rezultat i nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë, me amendamentin VII²⁷, neni 19 u ndryshuan paragrafët 3 dhe 4, ku pas emrit të KOM-it shtohen edhe fjalët “si dhe Bashkësia Fetare Islame, Kisha Katolike, Kisha Evangjeliste Metodiste dhe Komuniteti Hebre”, dhe në dispozitat e theksuara sot thuhet:

Kisha Ortodokse Maqedonase, si dhe Bashkësia Fetare Islame në Maqedoninë, Kisha Katolike, Kisha Ungjillore Metodiste, Komuniteti Hebre, bashkësitë tjera fetare dhe grupet religjioze janë të ndara nga shteti dhe të barabartë para ligjit. Kisha Ortodokse Maqedonase, si dhe Bashkësia Fetare Islame në Maqedoni, Kisha Katolike, Kisha Ungjillore Metodiste, Komuniteti Hebre, bashkësitë tjera fetare dhe grupet religjioze janë të lira të krijojnë shkolla fetare dhe institucione sociale dhe bamirëse, në përputhje me procedurën e përcaktuar me ligj.

Kushtetuesja ka garantuar gjerësisht lirinë e fesë, ku veçanërisht është theksuar statusi i KOM-it²⁸. Kisha Ortodokse Maqedonase është përmendur e para me ndarjen e saj konkrete nga organizatat e tjera fetare të përmendura sipas emrave me fjalët “si dhe”.

3. Liritë dhe të drejtat e pakicave të përcaktuara në nenin 49, paragrafët 1, 2 dhe 3 të Kushtetutës

Sipas nenit 48 të tekstit origjinal të Kushtetutës, pjesëtarët e grupeve të ndryshme etnike kishin të drejtë të shprehin lirisht, të nxisin dhe të zhvillojnë identitetin e tyre (paragrafi 1), në të cilin në mënyrë të pakontestueshme përfshihej edhe ai fetar, megjithëse në këtë nen është përdorur formulimi më i përgjithshëm pa specifikuar identitetet e veçanta.

27 *Amendamentet IV, V, VI, VII, VIII, IX, X, XI, XII, XIII, XIV, XV, XVI, XVII dhe XVIII t; Kushtetutës s; Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, viti: LVII, nr.: 91, Shkup, 20.11.2001, f.: 5019-5021.*

28 Më shumë shih: Gordana Siljanovska, *Democracy in Multiethnic and Multicultural Society: between Demos and Ethnos*, Macedonia in Globalisation, Public Scholarly Publications, New York, 2004.

Në paragrafin tjetër, Republika e Maqedonisë së Veriut garanton mbrojtjen e identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga prejardhja e tyre etnike, e cila mund të realizohet përmes së drejtës për të themeluar institucione për kulturë dhe art, si dhe shoqata të tjera (paragrafi 3).

Si rezultat i rikompozimit kushtetues të nenit 48 me amendamenti VIII në vitin 2001, u ruajt thelbi i njëjtë në lidhje me të drejtat, si dhe garancitë e shtetit, ku termi *“pjesëtarë të nacionaliteteve”* u zëvendësua me termin *“pjesëtarë të bashkësive”*.

4. Garancitë e lirive dhe të drejtave themelore të përcaktuara në nenin 50, nenin 110 alineja 3, si dhe në nenin 20 paragrafi 3 të Kushtetutës

Sipas këtyre dispozitave, çdo qytetar mund të thirret në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të përcaktuara me Kushtetutë, përmes një procedure të bazuar në parimet e prioritetit dhe urgjencës (neni 50) para Gjykatës Kushtetuese të Maqedonisë së Veriut (neni 110, pika 3). Si garanci plotësues, neni 20, paragrafi 3 thotë se programet dhe aktivitetet e partive politike dhe shoqatave të tjera të qytetarëve nuk mund të drejtohen në përmbyse të dhunshme të rendit kushtetues të Republikës, as në inkurajimin ose nxitjen e agresionit ushtarak, ngjalljen e urrejtjes ose intolerancës etnike, racore ose fetare.

5. Kufizimet e lirive dhe të drejtave të përcaktuara në nenin 54 të Kushtetutës

Neni 54 merret me kufizimin e të drejtave dhe lirive të individit dhe qytetarit gjatë gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme në përputhje me dispozitat e Kushtetutës (paragrafët 1 dhe 2). Dy paragrafët tjerë shprehen se kufizimi i të drejtave dhe lirive nuk mund të diskriminojë qytetarët për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës së lëkurës, gjuhës, fesë, origjinës kombëtare ose shoqërore, pronës ose statusit shoqëror (paragrafi 3), dhe se një kufizim i tillë nuk mund të zbatohet për të drejtën e jetës, ndalimin e torturës, sjelljen çnjerëzore dhe poshtëruese dhe dënimin, përcaktimin ligjor të veprave dhe dënimeve, as për lirinë e bindjes personale, ndërgjegjes, mendimit dhe fesë (paragrafi 4).

Me këto paragrafë, Kushtetuta në të vërtetë përcakton kufijtë në lidhje me modelin maqedonas të marrëdhënieve me organizatat fetare dhe lirinë e fesë.

Dispozitat kushtetuese të sipërpërmendura çojnë në përfundimin se Republika e Maqedonisë së Veriut ka krijuar një koncept të gjerë të barazisë midis qytetarëve duke garantuar të drejtat përkatëse, bazuar, ndër të tjera, në vetëpërcaktimin e pavarur fetar të qytetarëve.

Shteti, gjithashtu ofron një garanci të gjerë të lirisë së fesë, duke i lejuar qytetarët e tij të shprehin lirisht fenë e tyre, individualisht ose në bashkësi me të tjerët. Kjo i lejon komunitetet fetare të krijojnë shkolla fetare, si dhe institucione shoqërore dhe bamirëse, përmes një procedure të rregulluar me ligj.

Organizatat fetare brenda të cilave shprehet feja janë të ndara në tre grupe: në grupin e parë hyn KOM-i, në grupin e dytë hynë BFI-ja, Kisha Katolike, Kisha Evangjeliste Metodiste dhe Komuniteti Hebre, ndërsa në grupin e tretë nën kategorinë “ bashkësitë e tjera fetare dhe grupet religjioze” hynë organizatat e tjera të vogla fetare. Ky klasifikim nuk ka për qëllim të përcaktojë fusha të ndryshme ose lloje të të drejtave dhe lirive, por përkundrazi pasqyron aspekte historike, shtetndërtuese dhe simbolike që janë thelbësore për karakterin e identitetit fetar të shtetit maqedonas, i cili bazohet kryesisht në trashëgiminë e krishterë ortodokse.

Përveç garancive të përgjithshme, Kushtetuta gjithashtu ofron garanci të tjera të veçanta në lidhje me organizatat fetare të pakicave, zhvillimin dhe forcimin e identitetit të tyre të përgjithshëm dhe fetar.

Liritë dhe të drejtat fetare mbrohen nga shteti përmes Gjykatës Kushtetuese.

Përfundimisht, shteti parasheh gjithashtu mundësinë e kufizimit të të drejtave dhe lirive të individit dhe qytetarit gjatë gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme. Sidoqoftë, kufizime të tilla mund të mos jenë diskriminuese bazuar në fe, ndër të tjera, dhe kufizimi i të drejtave dhe lirive nuk mund të zbatohet në shprehjen e lirisë fetare.

1.1 KONCEPTET TJERA KUSHTETUESE

Gjatë periudhës së miratimit të Kushtetutës së RMV-së, gjithashtu u diskutuan disa koncepte të tjera kushtetuese për përcaktimin e marrëdhënieve midis shtetit dhe organizatave fetare, si dhe lirinë e fesë. Disa prej tyre u ekspozuan në debatet për miratimin e Kushtetutës në vitin 1991, si dhe gjatë negociatave për miratimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit në 2001.

Në vitin 1991, gjatë debatit në Kuvend për përmbajtjen e kushtetutës së parë pluraliste të Republikës së Maqedonisë së Veriut, u propozuan një numër i madh ndryshimesh. Si propozim më specifik do të veçonim propozim-amendamentin, sipas të cilit një nen i ri 1 duhej të shtohet në nenin ekzistues ¹²⁹, me të cilin propozohej:

²⁹ Jordan Boškov, Member of the Assembly from VMRO-DPMNE, *Amendment 1 to the Draft Constitution of the Republic of Macedonia*, Archive of the Assembly of the Republic of Macedonia, 41/4506, 7.11.1991.

*Republika e Maqedonisë është e bekuar nga Zotit.
Feja zyrtare është krishterimi Ortodoks.*

Propozuesi i këtij amendamenti arsyetoi propozimin duke thënë se: “Pavarësisht nëse pranohet ose jo, Zoti e ka krijuar botën dhe të gjitha veprimet njerëzore janë të bekuara nga Zoti”³⁰. Në këtë drejtim, ai argumentoi që paragrafi i dytë i nenit 1 të propozuar duhet të ndërlidhej gjithashtu me *“traditën ortodokse e cila është baza e ekzistencës së përgjithshme të kombit maqedonas sot”*³¹.

Gjatë debatit në Kuvend, gjithashtu u shpreh pikëpamja e kundërt, duke theksuar parimin e shekullarizmit dhe nevojën për të ndarë shtetin nga organizatat fetare. Argumenti u bazua në faktin se përmendja e vetëm krishterimit ortodoks nuk përputhej me realitetin e Maqedonisë Veriore RMV³². Në fund, amendamenti i propozuar nuk e mori numrin e duhur të votave dhe u refuzua.

Gjatë debateve mbi Kushtetutën, u propozuan tre ndryshime karakteristike në nenin 19, në lidhje me lirinë e fesë dhe statusin e organizatave fetare. Polemikën më të ashpra u shkaktuan nga paragrafi 3:

Kisha Ortodokse Maqedonase, komunitetet e tjera fetare dhe grupet religjioze janë të ndara nga shteti dhe janë të barabartë para ligjit.

Në amendamentin e parë³³, propozuesi parashikonte që në paragrafin e ri të thuhet:

Kisha Ortodokse Autoqefale e Maqedonisë si vazhdim i traditave dhe punës së Kryepeshkopatës së Ohrit, ka një status të veçantë dhe i nënshtrohet një interesi të veçantë publik.

Arsyeja e miratimit të këtij amendamenti, u argumentua se *“KOM-i ka një rëndësi të madhe historike për ekzistencën e kombit maqedonas. Ajo ka luajtur dhe luan një rol të rëndësishëm në ekzistencën shpirtërore të maqedonasve”*³⁴, dhe se *“theksimi i pozitës së veçantë të kishës ortodokse maqedonase midis organizatave fetare bëhet për shkak të faktit se ato kanë selitë e tyre janë jashtë territorit të Republikës së Maqedonisë dhe*

30 Jordan Boshkov, deputet i OBRM-PDUKM), *Amendamenti I i Propozim-kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut*, op.cit.

31 Ibid.

32 Mbledhja e 25-të e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut Shënime stenografike, 9.11.1991, f.: 157-159.

33 Todor Petrov, deputet i pavarur, *Amendamenti XX i Propozim-kushtetutës së Republikës së Maqedonisë*, Arkivi i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 6.11.1991.

34 Ibid.

u referohen grupeve kryesore fetare, ndërsa KOM-i është me seli në RM dhe është kishë kombëtare e popullit maqedonas³⁵.

Amendamenti tjetër në nenin 19³⁶ u propozua për arsye krejt të kundërta që i shqyrtuam për amendamentin e parë. Në nenin 19 paragrafi 3 u propozua ky ndryshim:

Kisha Ortodokse Maqedonase dhe Bashkësia Fetare Islame janë të ndara nga shteti dhe të barabartë para ligjit.

Propozuesi argumentoi se ai propozoi këtë ndryshim në mënyrë që të “sigurojë status të barabartë për të gjitha organizatat fetare në shtet³⁷”.

Duke marrë parasysh karakterin plural të pasqyrës fetare në Maqedoninë e Veriut, konstatohet se autori propozoi këtë ndryshim me qëllim që të sigurojë një pozitë të privilegjuar për dy komunitetet më të mëdha fetare të vendit, por jo edhe të gjitha komunitetet e rëndësishme konfesionale në vend.

Dhe në fund, amendamenti i tretë i propozuar i nenit 19³⁸ parashikonte një zgjidhje krejtësisht të re:

Komunitetet fetare dhe grupet religjioze janë të ndara nga shteti dhe të barabartë para ligjit.

Nevoja për miratimin e këtij amendamenti kushtetues u argumentua si vijon: “Pozicioni i veçantë i KOM-it në luftën për emancipimin e popullit maqedonas nuk duhet të theksohet brenda Kushtetutës, por të bëhej me një akt tjetër. Kushtetuta duhet t’i përcaktojë thjesht marrëdhëniet midis shtetit dhe feve³⁹”.

Asnjëri nga tre ndryshimet e propozuara në nenin 19 nuk mori numrin e duhur të votave për miratim, duke mbetur kështu gjithçka në tekstin e tij fillestar.

Neni 19, paragrafët 3 dhe 4 përsëri ishin objekt i negociatave kushtetuese në vitin 2001 kur qe nënshkruar Marrëveshja Kornizë⁴⁰. Gjatë nënshkrimit të Marrëveshjes

35 Ibid.

36 Muhamed Halili, deputet i PPD-së, *Amendamenti II i Propozim-kushtetutës së Republikës së Maqedonisë*, Arkivi i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 41/4460, 6.11.1991.

37 Ibid.

38 Grupi parlamentar i LSDM-së, *Amendamenti II i Propozim-kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut*, Arkivi i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 41/4495, 7.11.1991.

39 Ibid.

40 Marrëveshja Kornizë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Sekretariati për Zbatimin e Marrëveshjes Kornizë (siofa.gov.mk), 7.3.2018.

Kornizë të Ohrit në vitin 2001, neni 19, paragrafët 3 dhe 4 u bënë edhe një herë objekt i negociatave mbi Kushtetutën. Gjatë negociatave në Ohër, ishte rënë dakord për një tekst të ri për paragrafët 3 dhe 4 të nenit 19 (Amendamenti VII)⁴¹, megjithatë, një tekst krejtësisht tjetër i ishte propozuar Kuvendit. Teksti u miratua dhe është ende pjesë e Kushtetutës:

"Kisha Ortodokse Maqedonase, si dhe Bashkësia Fetare Islame në Maqedoni, Kisha Katolike, Kisha Ungjillore Metodiste, Komuniteti Hebre dhe bashkësitë tjera fetare, dhe grupet religjioze ..."

Në ndryshimin e propozuar të Nenit 19, i cili ishte paraqitur gjatë hartimit të Marrëveshjes Kornizë, përveç KOM-it, përmendeshin vetëm BFI-ja dhe Kisha Katolike:

"Kisha Ortodokse Maqedonase, Bashkësia Fetare Islame në Maqedoni, Kisha Katolike dhe bashkësitë tjera fetare, dhe grupet religjioze ..."

Ndryshimi në tekstin e dakorduar të Nenit 19 u diskutua ashpër gjatë debatit në Kuvend, i cili, edhe një herë, demonstroi pozicionet e ndryshme të partive politike në çështjen e marrëdhënieve midis shtetit dhe organizatave dhe grupeve fetare.

Sipas një pjese të partive, *"përmendja e Kishës Metodiste Ungjillore në Kushtetutë përfaqëson një keqpërdorim të autoritetit nga Presidenti i RM-së"*⁴², i cili ishte anëtar i asaj kisha atëherë, pasi *"ka bashkësi fetare me një numër më të madh të anëtarëve, dhe ato nuk përmenden në Kushtetutë"*⁴³.

Një grup tjetër parlamentar shprehu pakënaqësi serioze ndaj amendamentit VII për formulimin *"si dhe"*, pas përmendjes së KOM-it, të ndjekur nga organizatat më të mëdha fetare. Ata e konsideruan këtë ndërtim të fjalisë për të *"vendosur organizatat e tjera fetare në një pozitë të pabarabartë"*⁴⁴, duke iu referuar, para së gjithash, BFI-së.

Megjithatë, një grup tjetër i deputetëve, gjithashtu kundërshtoi amendamentin VII, duke argumentuar se *"përveç KOM-it, asnjë organizatë fetare nuk duhet të përmendet me emër, sepse Maqedonia është shtet Ortodoks, kështu që Kisha Ortodokse është e privilegjuar dhe luan një rol dominues në të"*⁴⁵.

41 Ibid.

42 Nikola Popovski, deputet i Kuvendit nga LSDM, seanca e 86-të e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, vazhdimi i pestë, shënime Steganografike, (sobranie.mk), 7.3.2018, f. 15-16

43 Ibid.

44 Ismet Ramadani, deputet i PPD-së, *Mbledhja e 86-të e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, vazhdimi i 5-të*, Shënime stenografike (sobranie.mk), 7.3.2018, f.: 16-17.

45 Tomislav Petrovski, deputet i OBRM-PDUKM (VMRO-DPMNE), *Mbledhja e 86-të e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, vazhdimi i 5-të*, Shënime stenografike op.cit. (sobranie.mk), 7.3.2018, f.: 20-21.

Kjo përmbledhje e amendamenteve të propozuara dhe e Kushtetutës së ndryshuar në versionin e saj përfundimtar në vitin 2001 pasqyron më së miri pozicionet e partive të ndryshme në lidhje me çështjen e kufijve të parimit të shekullarizmit. Mund të konkludojmë se ndryshimet e miratuara përfaqësojnë një kombinim të tre faktorëve që përcaktojnë modelin maqedonas të marrëdhënieve me organizatat fetare, edhe pse ekuilibri midis tyre u zhvendos dukshëm në drejtim të realitetit aktual. KOM-i u njoh si e para midis të barabartëve: BFI-së, Kishës Katolike, Kishës Ungjillore Metodiste dhe Komuniteti Hebre, si dhe bashkësitë tjera më të vogla dhe grupet religjioze.

2

**LIGJI PËR STATUSIN JURIDIK
TË KISHËS, BASHKËSISË
FETARE DHE
GRUPET RELIGJIOZE**

2. LIGJI PËR STATUSIN JURIDIK TË KISHËS, BASHKËSISË FETARE DHE GRUPET RELIGJIOZE

Ligji i parë që rregullon në detaje marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe organizatave fetare si dhe lirinë e fesë në Republikën e Maqedonisë së Veriut pas pavarësisë së saj u miratua në korrik 1997⁴⁶.

Arsyet për miratimin e një ligji të tillë qëndronin në proceset e transformimit të shoqërisë dhe sistemit politik sipas parimeve demokratike, duke marrë parasysh që shtatë vjet nga pavarësia e saj, Republika e Maqedonisë ende kishte në fuqi ligjin socialist të vitit 1977 për statusin juridik të bashkësive fetare⁴⁷.

Me këtë ligj, neni 19 i Kushtetutës⁴⁸ u bë operacional në lidhje me marrëdhëniet e shtetit ndaj organizatave fetare, si dhe dispozitat e tjera kushtetuese, kryesisht në lidhje me çështjen e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut.

Qëllimi i ligjit ishte *unifikimi i marrëdhënieve në fushën e fesë në RM në përputhje me parimet kushtetuese, si dhe me arritjet më të fundit të civilizimit dhe standardeve ndërkombëtare*, pasi dispozitat e ligjit të atëhershëm në fuqi, të vitit 1977, për statusin juridik të bashkësive fetare ishin të ngarkuara me elemente ideologjike që nuk korrespondonin me realitetin e ri demokratik⁴⁹.

Pas miratimit të Ligjit për bashkësitë dhe grupet fetare, u dërguan në Gjykatën Kushtetuese tri kërkesa për shfuqizimin e disa prej dispozitave të tij, përkatësisht:

- » Në vitin 1998⁵⁰, disa grupe protestante-krishtere ndërmorën një iniciativë që të nisat procedurë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së tetë neneve të ligjit. Gjykata Kushtetuese dha përgjigje pozitive për gjashtë nenet, ndërsa për dy nenet dhe përgjigje negative, d.m.th. e refuzoi iniciativën.

46 *Ligji për bashkësitë fetare dhe grupet religjioze*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LIII, nr.: 35, Shkup, 23.7.1997, f.: 1426-1429.

47 *Ligji për statusin juridik të bashkësive fetare*, Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste të Maqedonisë, viti: XXXIII, nr.: 39, Shkup, 14.11.1977, f.: 860-862.

48 *Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: XLVII, nr.: 52, op.cit.

49 *Propozim për miratimin e ligjit për bashkësitë fetare dhe grupet religjioze, arsyet e miratimit të Ligjit*, Arkivi i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut 313/1, 31.1.1997.

50 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Aktvendimi nr. 10/2004, 12.5.2004.

- » Me iniciativën e vitit 1999⁵¹, të paraqitur nga një organizatë joqeveritare që propozuar të nisej procedurë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dy neneve të ligjit. Gjykata Kushtetuese u përgjigj pozitivisht, dhe
- » Me iniciativën e vitit 2004⁵², të paraqitur nga një person fizik, që propozuar të niset procedurë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së dy neneve të Ligjit, me ç'rast Gjykata Kushtetuese u përgjigj negativisht, dmth. refuzoi iniciativën.

Nga ajo që u tha më sipër, mund të konkludohet se **nga gjithsej 37 nenet e Ligjit për bashkësitë fetare dhe grupet religjioze, 12 nene u kontestuan, dhe 8 prej tyre u gjetën në kundërshtim me Kushtetutën nga gjykatësit e Gjykatës Kushtetuese dhe në këtë mënyrë u shfuqizuan**, ndërsa për 4 nenet u përgjigjën negativisht, dmth. kërkesa për shfuqizimin e tyre u refuzua, në mënyrë që ato të mbeten pjesë e Ligjit.

Me iniciativat e paraqitura dhe me vendimet për shfuqizimin e tetë neneve të Ligjit, ky akt juridik ka humbur praktikisht kuptimin e tij themelor, dmth. u bë i pazbatueshëm në praktikë.

Prandaj, pas dhjetë viteve të para të pavarësisë, Republika e Maqedonisë së Veriut ende nuk kishte arritur ta rregullojë këtë fushë në mënyrë të kënaqshme.

Dhjetë vjet pas hyrjes në fuqi të ligjit të parë⁵³, u miratua akti i dytë⁵⁴, me të cilin në detaje u rregulluan çështjet e marrëdhënieve të RMV-së me organizatat fetare, si dhe liria e fesë.

Ligji mbi statusin juridik të kishave, bashkësinë fetare dhe grupin religjioz u miratua sepse ligji i mëparshëm ishte i pazbatueshëm, kryesisht për shkak të dy vendimeve të Gjykatës Kushtetuese që kishin çuar në shfuqizimin e disa prej neneve kryesore të tij.

Ligji për statusin juridik të kishës, Bashkësinë Fetare dhe grupin religjioz përbëhet prej 37 neneve në pesë kapituj të veçantë.

Kapitulli i parë i Ligjit për statusin juridik të kishave, bashkësinë fetare dhe grupet religjioze përfshinë dispozitat e përgjithshme në 8 nene, të strukturuar si më poshtë:

51 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut, *Aktvendimi nr.: 114/1999-1-0*, 9.9.1999.

52 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut, *Aktvendimi nr.: 10/2004*, 12.5.2004.

53 *Ligji për bashkësitë fetare dhe grupet religjioze*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LIII, nr.: 35, op.cit.

54 *Ligji për statusin juridik të kishës, bashkësisë fetare dhe grupit religjioze*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, viti: LXIII, nr.: 113, Shkup, 20.9.2007, f.: 1-4.

1. Objekt i Ligjit është përcaktuar (neni 1, paragrafi 1) është konfirmuar dispozita kushtetuese për ndarjen e shtetit nga organizatat fetare (neni 1, paragrafi 2).
2. Kategoritë “kisha, bashkësia fetare dhe *grupi religjioz*”, përcaktohen si bashkësi vullnetare të personave fizikë të cilët, bazuar në bindjet e tyre fetare dhe burimet e mësimeve të tyre, ushtrojnë lirinë e fesë, të bashkuar në besimin dhe identitetin e tyre, të shprehura në forma identike të adhurimit, lutjes, ritualeve dhe formave të tjera të besimit (neni 2, paragrafi 1). **Në këtë pjesë ka dallimet të rëndësishme në krahasim me ligjin e mëparshëm.** Nuk bëhet dallime midis kategorive “bashkësi fetare” dhe “grup religjioz”, zbatohet emërtimi i njëjtë. Ndërkaq, në versionin ri të ligjit është hequr dispozita që ekzistonte në ligjin e mëparshëm me të cilën parashikohej se për një fe mund të ekzistoj vetëm bashkësi fetare;
3. Kategoria “klerik” përcakton: personin në shërbim të një grupi religjioz në të cilin është anëtar, bazuar në bindjet e vet fetare, i cili kryen veprimtari fetare, rituale, edukative, organizative dhe bamirëse sipas normave të organit më të lartë të organizatës fetare të regjistruar, në përputhje me Kushtetutën, ligjet dhe dispozitat ligjore të Republikës së Maqedonisë së Veriut (neni 2, paragrafi 2).
4. Të drejtat dhe liritë e qytetarëve në lidhje me fenë janë specifikuar:
 1. E drejta e lirisë së bindjes, ndërgjegjes dhe mendimit, e cila përfshin lirinë e shprehjes fetare, vetëm ose me të tjerët (neni 3).
 2. Ndalohet diskriminimi fetar (neni 4, paragrafi 1).
 3. Besimi fetar nuk i heq qytetarët nga detyrat e tyre sipas Kushtetutës, ligjeve dhe dispozitave të tjera, nëse nuk rregullohet ndryshe në ligje ose dispozita të tjera (neni 4, paragrafi 2).
5. Të drejtat e organizatave fetare janë të përcaktuara:
 1. Organizatat fetare kanë të drejtë të organizohen lirshëm brenda organeve të tyre drejtuese, hierarkisë dhe kompetencave dhe të emërojnë persona që i përfaqësojnë [si] dhe të miratojnë akte në lidhje me të (neni 5);
 2. Organizatat fetare i kryejnë veprimtaritë e tyre në përputhje me dispozitat ligjore të shtetit, deklaratat dhe konventat ndërkombëtare për lirinë e fesë dhe lirinë e shprehjes fetare (neni 7, paragrafi 1).
6. Raporti i shtetit me organizatat fetare përcaktohet:
 1. Shteti respekton identitetin e organizatave fetare dhe krijon me ta marrëdhënie dialogu të vazhdueshëm dhe zhvillon forma të bashkëpunimit të vazhdueshëm (neni 6);
 2. Në përputhje me detyrat dhe autorizimet e tyre, organet shtetërore krijojnë kushte që organizatat fetare të kryejnë aktivitetet e tyre të papenguara (neni 7, paragrafi 2).

7. Përcakton kushte dhe rrethanat në të cilat mund të kufizohet liria e shprehjes fetare dhe e shprehjes së besimit. Ndërkaq, kjo mund të bëhet vetëm me ligj, nëse konsiderohet e domosdoshme në emër të sigurisë publike, rendit, shëndetit, moralit ose mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të qytetarëve të tjerë (neni 8).

Në kapitullin e dytë të Ligjit, përshkruhet statusi ligjor i organizatave fetare. Nëntë nenet e saj trajtojnë çështjet se si një organizatë fetare mund të arrijë statusin e një subjekti juridik. Për këtë qëllim, përcaktohen dy rregulla themelore:

1. Emri dhe simbolet zyrtare të çdo organizate të re fetare duhet të jenë të ndryshme nga emrat dhe simbolet zyrtare të organizatave fetare tashmë të regjistruara (neni 10 paragrafi 1);
2. Fjala Maqedoni, derivatet dhe përkthimet e saj, si dhe flamuri shtetëror dhe stema mund të jenë pjesë e emrit dhe simboleve të një organizate fetare, nëse përdoret në një mënyrë që thekson reputacionin dhe dinjitetin e Republikës së Maqedonisë (Neni 10, paragrafi 2). Ministria e Drejtësisë duhet të japë pëlqimin e saj me shkrim për përdorimin e emrit Maqedoni (neni 10, paragrafi 3).

Kapitulli i tretë i Ligjit trajton çështje që lidhen me adhurimin, lutjen dhe ritualet. Sipas Ligjit, organizatat fetare i kryejnë këto forma të aktiviteteve në ambiente fetare, të tilla si kisha, xhami, vende për lutje, sinagoga, në varreza, si dhe objekte të tjera që janë pronë e organizatave fetare (neni 18, paragrafi 1), si dhe në ambiente të tjera dhe hapësira publike (neni 18, paragrafi 2). Aktivitetet fetare mund të organizohen dhe ushtrohen nga një klerik ose një person tjetër i autorizuar nga organizata fetare (neni 18, paragrafi 3).

Çdo lloj përfaqësimi i shtirur i një kleriku, si dhe keqpërdorimi i veshjeve dhe simboleve fetare të organizatave fetare të regjistruara është i ndaluar me Ligj, (neni 18, paragrafi 5).

Kapitulli i katërt i ligjit rregullon çështjet që lidhen me mësimet fetare dhe veprimtaritë edukative duke garantuar të drejtën e organizatave fetare për të zhvilluar mësimet fetare (neni 21 paragrafi 1) në ambientet në të cilat kryejnë shërbime fetare, si dhe në ambiente dhe vende të tjera publike dhe private, nëse nuk cenon rendin dhe paqen publike (neni 21 paragrafi 2).

Gjithashtu, sipas Ligjit, organizatat fetare kanë të drejtë të themelojnë institucione arsimore fetare në të gjitha niveleve të arsimit, përveç arsimit fillor, për edukimin e klerit dhe nëpunësve fetarë, si dhe konvikte të nxënësve dhe studentore për

vendosjen e personave që arsimohen në këto institucione (neni 22 paragrafi 1), ku ata janë të barabartë me institucionet e tjera arsimore dhe nxënësit dhe studentët e tyre i kanë të drejtat dhe obligimet e njëjtat (neni 22 paragrafi 2).

Mësimi në organizatat fetare mund të ushtrohet nga shtetasit e Republikës së Maqedonisë së Veriut (neni 25, paragrafi 1), megjithatë, përjashtimisht, nëse organizatat fetare kanë nevojë për personel përkatës, mësimin mund ta zhvilloj edhe një shtetas i huaj, në përputhje me dispozitat për vendbanimin e shtetasve të huaj dhe me pëlqimin e Komisionit për Marrëdhënie me Bashkësitë Fetare dhe Grupet Religjioze (neni 25, paragrafi 2).

Sipas Ligjit, organizatat fetare janë të pavarura në administrimin e institucioneve të tyre fetare dhe institucioneve të tjera arsimore, si dhe me konviktet e nxënësve dhe të studentëve (neni 26, paragrafi 1). Personi i ngarkuar ka për detyrë t'i sigurojë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të gjitha të dhënat e kërkuara për inspektimin e aktiviteteve të tyre dhe të korrigjojë mangësi të mundshme brenda një periudhe kohore të përcaktuar nga Ministria (neni 26, paragrafi 2).

Ligji rregullon edhe çështjen e edukimit fetar në institucionet edukativo-arsimore që mund të organizojnë arsim fetar (neni 27 paragrafi 1), ku përgatitja e planit dhe programit mësimor me të cilët përcaktohet lënda zgjedhore në fushën e edukimit fetar mund të bëhet përmes Komisionit për Marrëdhënie me Bashkësitë Fetare dhe Grupet Religjioze dhe në konsultim me organizatat fetare (neni 27 paragrafi 2).

Edukimi fetar si lëndë zgjedhore mund të kryhet nga persona që plotësojnë kushtet e veçanta të përcaktuara për këtë qëllim (neni 28). Nxënësit nën moshën 15 vjeç mund të marrin mësim fetare vetëm me pëlqimin e prindërve të tyre ose kujdestarëve ligjorë (neni 29).

Kapitulli i pestë i Ligjit rregullon çështjet që lidhen me të ardhurat e organizatave fetare. Të ardhurat e organizatave fetare rrjedhin nga vetëfinancimi, filantropia private, donacionet dhe format e tjera të financimit (neni 32). Organizatat fetare administrojnë në mënyrë të pavarur financat e tyre në përputhje me ligjin dhe dispozitat e tyre të brendshme (neni 33, paragrafi 1). Financimi dhe shpenzimi i mjeteve financiare kryhen në përputhje me rregulloren për organizatat jofitimprurëse dhe organizatat me interes publik (neni 33, paragrafi 2).

Kapitulli i gjashtë i Ligjit përmban dispozita kalimtare dhe përfundimtare, përfshirë afatet për miratimin e akteve nënligjore (neni 34), detyrat e Komisionit për Marrëdhënie me Bashkësitë Fetare dhe Grupet Religjioze në lidhje me të dhënat për organizatat fetare të regjistruara tashmë (neni 35), dhe hyrja në fuqi e Ligjit (neni 37).

2.1 KONCEPTET TJERA LIGJORE

Gjatë debatit në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut mbi Ligjin mbi statusin juridik të kishave, bashkësive fetare dhe grupeve religjioze, u propozuan ndryshime të shumta, dy prej të cilëve do t'i veçonim për shkak të rëndësisë së tyre në lidhje me temat e këtij manuali.

Me ndryshimet e propozuara, në Ligj u shtuan dy nene (neni 7-a pas nenit 7⁵⁵ dhe neni 33-a pas nenit 33⁵⁶), me të cilët propozuesit parashikuan katër situata të reja:

1. Një klerik nuk mund të thirret për të dëshmuar në lidhje me faktet dhe rrethanat për të cilat ka dëgjuar gjatë rrëfimit (Draft-neni 7-a, paragrafi 1⁵⁷).
2. E dyta, nëse organi kompetent privon nga liria një nëpunës fetar, ai është i detyruar të njoftojë organin kompetent të organizatës fetare (propozim-neni 7-a, paragrafi 2⁵⁸);
3. Republika e Maqedonisë së Veriut mbron veshjen fetare, pjesët e saj, si dhe karakteristikat, statusin dhe dinjitetin e klerikëve në atë mënyrë që thekson reputacionin e organizatës fetare (Drafti i Neni 7-a, paragrafi 3).
4. Ndryshimi përfshiu mundësinë që shteti të financojë sigurimin shëndetësor, pensional dhe invalidor të klerikëve të organizatave fetare (propozim-neni 33-a, paragrafi 1⁵⁹) në proporcion me numrin e besimtarëve në organizatat fetare të regjistruara (propozim-neni 33-a, paragrafi 2⁶⁰).

Autorët përmendën dy arsye kryesore për ndryshimet e tyre të propozuara:

1. Forcimin e lirisë së fesë si një vlerë themelore kushtetuese dhe lirisë kushtetuese⁶¹, dhe
2. Forcimi i autonomisë së organizatave fetare⁶².

55 Aleksandar Spasenovski bashkë me një grup të deputetëve të OBRM-PDUKM dhe të PDSH-së, *Amendamenti për plotësimin me një neni të ri 7-a të Ligjit për statusin juridik të kishës, bashkësisë fetare dhe grupit religjioz*, 3230/3, 31.8.2007.

56 Aleksandar Spasenovski bashkë me një grup të deputetëve të OBRM-PDUKM dhe të PDSH-së, *Amendamenti për plotësimin me një neni të ri 33-a të Ligjit për statusin juridik të kishës, bashkësisë fetare dhe grupit religjioz*, 3230/2, 31.8.2007.

57 Aleksandar Spasenovski bashkë me një grup të deputetëve të OBRM-PDUKM dhe të PDSH-së, *Amendamenti për plotësimin me një neni të ri 7-a të Ligjit për statusin juridik të kishës, bashkësisë fetare dhe grupit religjioz*, op.cit.

58 Ibid.

59 Aleksandar Spasenovski bashkë me një grup të deputetëve të OBRM-PDUKM dhe të PDSH-së, *Amendamenti për plotësimin me një neni të ri 33-a të Ligjit për statusin juridik të kishës, bashkësisë fetare dhe grupit religjioz*, op.cit.

60 Ibid.

61 Ibid.

62 Ibid.

Në dallim nga propozuesit të cilët i kanë shpjeguar arsyet e tyre për propozimin e amendamenteve, kundërshtarët mendonin se çështjet e propozuara në amendamente duhet të ishin rregulluar me akte të tjera, dhe jo me ligji, dhe nëse ato do të pranoheshin, mund të krijonin obligime të rëndësishme për shtetin, për të cilat nuk ishte e sigurt nëse shteti mund t'i përmbushte ato⁶³.

Në lidhje me këto amendamente, si në rastet e mëparshme kur u miratua Kushtetuta, si dhe gjatë miratimit të Ligjit për bashkësitë fetare dhe grupet religjioze, përsëri u shfaqën qëndrimet e ndryshme të partive politike rreth kufijve të shekullarizmit në RMV.

Në fund, të dy amendamentet nuk e morën shumicën e nevojshme, duke bërë që ato të mos jenë pjesë përbërëse e Ligjit për statusin juridik të kishës, bashkësitë fetare dhe grupit religjioz.

2.2 AKTVENDIMET DHE VENDIMET E GJYKATËS KUSHTETUESE

Në vitin 2009, më pak se dy vjet pas miratimit të Ligjit për Statusin Juridik të Kishës, Komunitetet Fetare dhe Grupet religjioze, në Gjykatën Kushtetuese u dorëzua iniciativa⁶⁴ për vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 4, paragrafi 2 dhe neneve 27, 28 dhe 29.

Me këtë iniciativë, parashtruesi kërkoi të vlerësohet përputhshmëria e nenit 4, paragrafi 2⁶⁵, si dhe e neneve 27⁶⁶, 28⁶⁷ dhe 29⁶⁸ të ligjit me Kushtetutën e RMV-së.

63 Mbledhja e 67-të e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, *Shënime Stenografike*, 5.9.2007, f.: 16-17.

64 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut, *Aktivendimi*, u. nr.: 104/2009-0-0, 23.6.2010.

65 Neni 4, Paragrafi 2 i Ligjit për statusin juridik të kishës, bashkësitë fetare dhe grupit religjioz - Bindja fetare nuk e liron qytetarin nga obligimet e tij që si qytetar i ka sipas Kushtetutës, ligjet dhe dispozitat tjera, përveç nëse nuk është rregulluar ndryshe me ligj ose ndonjë dispozitë tjetër. (*Ligji për statusin juridik të kishës, bashkësitë fetare dhe grupit religjioz*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, viti: LXIII, nr.: 113, op.cit.).

66 Neni 27 i Ligjit për statusin juridik të kishës, bashkësitë fetare dhe grupit religjioz - Në institucionet edukativo-arsimore mund të organizohet edukimi fetar si lëndë zgjedhore në përputhje me ligjin. Neni 27 i Ligjit për statusin juridik të kishës, bashkësitë fetare dhe grupit religjioz - Në institucionet edukativo-arsimore mund të organizohet edukimi fetar si lëndë zgjedhore në përputhje me ligjin. Gjatë përgatitjes së plan-programit mësimor me të cilin përcaktohet lënda zgjedhore nga fusha e edukimit fetar, përmes organit kompetent për çështjet lidhur me marrëdhëniet midis shtetit dhe bashkësive fetare mund të konsultohen kisha, bashkësitë fetare dhe grupet religjioze (*Ligji për statusin juridik të kishës, bashkësitë fetare dhe grupit religjioz*, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LXIII, nr.: 113, op.cit.).

67 Neni 28 i Ligjit për statusin juridik të kishës, bashkësitë fetare dhe grupit religjioz - Edukimin fetar si lëndë zgjedhore mund ta zhvillojnë personat të cilët i plotësojnë kushtet e veçanta të parashikuara për këtë qëllim (Ligji për statusin juridik të kishës, bashkësitë fetare dhe grupit religjioz, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LXIII, nr.: 113, op.cit.).

68 Neni 29 i Ligjit për statusin juridik të kishës, bashkësitë fetare dhe grupit religjioz - nxënësit nën moshën 15 vjeç mund të ndjekin arsimin fetar si lëndë me zgjedhje në bazë të pëlqimit të prindërve ose kujdestarit (*Ligji për statusin juridik të kishës, bashkësitë fetare dhe grupit religjioz*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. LXIII, nr.: 113, op.cit.).

Në lidhje me çështjen e harmonizimit të nenit 4 paragrafi 2 të ligjit me Kushtetutën, Gjykata Kushtetuese është deklaruar negativisht, përkatësisht ka hedhur poshtë iniciativën në këtë pjesë, ndërsa në lidhje me harmonizimin e neneve 27, 28 dhe 29 të ligjit me Kushtetutën, ku bëhet fjalë për nenet që rregullojnë çështjen e edukimit fetar në shkollat publike, gjykatësit kushtetues kanë vendosur të nisin procedura për vlerësimin e kushtetutshmërisë së tyre.

Pas procedurës para Gjykatës Kushtetuese, u soll Vendimi⁶⁹ (22.9.2010) me të cilin u shfuqizuan nenet e theksuara për shkak të kundërkushtetutshmërisë së tyre. Siç deklaruan gjykatësit kushtetues, me nenet e theksuara në ligj u tejkalua karakteri akademik dhe neutral i mësimin, i cili ishte karakteristik për arsimin publik, shtetëror dhe përfshiu shtetin në organizimin e mësimin të tillë fetar, përkundër parimit të theksuar të ndarjes së kishës nga shteti.

69 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut, *Vendimi u.6p.: 104/2009-0-1*, 22.9.2010.

3

**AKTET TJERA ME TË CILAT
PËRCAKTOHET STATUSI I
RELIGJIONEVE DHE LIRIA
E FESË NË REPUBLIKËN
E MAQEDONISË SË VERIUT**

3. AKTET TJERA ME TË CILAT PËRCAKTOHET STATUSI I RELIGJIONEVE DHE LIRIA E FESË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Përkundër dispozitave të analizuara kushtetuese dhe ligjore të analizuara, **qasja e Republikës së Maqedonisë së Veriut ndaj çështjeve që lidhen me statusin e organizatave fetare, si dhe ushtrimin e lirisë së fesë përcaktohet edhe me disa akte të tjera normative të miratuara ndër vite.**

Ato kontribuojnë në përcaktimin e karakterit të modelit pluralist të laicizmit të Maqedonisë së Veriut.

- » Aktet që rregullojnë ligjërisht çështjen e dëshmisë së përkatësisë fetare,
- » Kthimi i pronave të paluajtshme organizatave fetare në procesin e denacionalizimit,
- » Aktet që kanë të bëjnë me mbrojtjen kundër diskriminimit në baza fetare;
- » Kundërshtimi i ndërgjegjes,
- » Mësimbesimi në arsimin fillor,
- » Bekimet fetare në shkollat publike,
- » Statusi i institucioneve të arsimit të lartë të organizatave fetare,
- » Kremtimi shtetëror i festave fetare,
- » Statusi i akteve të organizatave fetare brenda sistemit juridik të Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- » Aktet që rregullojnë mbështetjen shtetërore të Kishës Ortodokse Maqedonase në luftën e saj për autoqefalen.

Më poshtë vijon shpjegimi i tyre më konkret:

3.1. DËSHMIMI I PËRKATËSISË FETARE

Me Kushtetutën e RMV-së, si dhe dispozitat ligjore që rrjedhin prej saj, është përcaktuar korniza juridike që rregullon marrëdhënien e shtetit ndaj organizatave fetare, si dhe ushtrimin e lirisë së fesë.

Ajo që mund të vërehet, që u theksua më sipër, është se **nuk ekzistojnë dispozita ligjore të qarta dhe të sakta që rregullojnë pyetjen se si qytetarët e RMV-së dëshmojnë përkatësinë e tyre në një fe të caktuar nëse ka nevojë për një gjë të tillë.**

Në këtë kuptim, Kushtetuta e RMV-së⁷⁰ ua garanton këtë të drejtë qytetarëve pa përcaktuar kriteret e caktuara për këtë qëllim.

Ligji për Bashkësitë Fetare dhe Grupet Religjioze i vitit 1997⁷¹, si dhe Ligji për statusin juridik të kishës, bashkësitë fetare dhe grupin religjioz i vitit 2007⁷², ka përpunuar vetëm në parim logjikën kushtetuese në këtë pjesë, që ka të bëjë vetëm me përcaktimin e të drejtave dhe detyrave të qytetarëve.

Kështu, për shembull, duke vepruar sipas kërkesës së personit Vasko Koteski për mbrojtje nga diskriminimi në bazë të përkatësisë fetare të nxitur nga një aktgjykim i dhënë nga Gjykata e Apelit në Manastir, Gjykata Kushtetuese e RMV-së, me vendim në korrik të vitit 2000⁷³, dha udhëzime se si të vërtetohet juridikisht përkatësia fetare e qytetarëve në shtet.

Sipas vendimit të Gjykatës Kushtetuese⁷⁴, natyra e çështjes është si vijon: Vasko Koteski ka munguar në vendin e punës më 29 janar dhe 7 prill të vitit 1998. Këto ditë ishin ditët e para të festave fetare të Bajramit të Madh, si dhe Bajramit të Vogël për besimtarët myslimanë, në përputhje me Ligjin për festat e RMV-së⁷⁵.

Parashtruesi i kërkesës e justifikoi këtë veprim para instancave gjyqësore duke pohuar se ai kishte pranuar fenë islame, për të cilën ai kishte konstatuar se ato ditë ishin ditë pushimi të ligjshme edhe për të, dhe personi nuk mund të vuante pasoja juridike për mosardhje në punë këto dy ditë.

Por, kompania ku personi punonte në të dyja rastet, dhe më vonë gjykatat, nuk e pranuan pretendimin e tij dhe, mungesën e tij në punë e konsideruan si të pabazë dhe në përputhje me rrethanat e sanksionuan.

Gjykata Kushtetuese, duke vepruar sipas kërkesës së Vasko Koteskit, ngriti dilemën nëse përkatësia e dikujt, përkatësisht përkatësia e një personi ndaj Islamit apo ndonjë feje tjetër mund të dëshmohet juridikisht?

70 *Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, viti: XLVII, nr.: 52, op.cit.

71 *Ligji për bashkësitë fetare dhe grupet religjioze*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, viti: LIII, nr.: 35, op.cit.

72 *Ligji për bashkësitë fetare dhe grupet religjioze*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LIII, nr.: 35, op.cit.

73 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut, *Vendimi u.6p.: 220/1999-0-0*, 12.7.2000.

74 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut, *Vendimi u.nr.: 220/1999-0-0*, op.cit.

75 *Ligji për festat në Republikën e Maqedonisë së Veriut*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, viti: V XIII, nr.: 18, Shkup, 15.2.2007, f.: 4-5.

Parashtruesi i kërkesës ka deklaruar me gojë se ai i takonte fesë islame, duke treguar se lidhjen e tij me një fe të caktuar nuk duhet ta vërtetojë as ai vetë, dhe askush tjetër nuk guxon të kërkoj prova prej tij, dhe as që ekziston ndonjë bazë për të nxjerrë dhe konfirmuar provat.

Gjykata e Apelit gjithashtu vlerësoi se përkatësia fetare e personit nuk mund të vërtetohej nga ndonjë fakt objektiv, duke konkluduar se deklarata e personit që ai kishte pranuar fenë islame do të thoshte vetëm një justifikim për mungesën e tij nga vendi i punës dhe asgjë më shumë.

Duke pasur parasysh këto fakte, në trajtimin e pretendimit të Koteskit, Gjykata Kushtetuese mbështetej në dy kriteret:

- » **E para**, se sundimi i së drejtës është një vlerë themelore e rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me të cilën duhet të supozohet mbizotërimi i normës juridike objektive mbi vullnetin subjektiv kur kërkon ushtrimin e të drejtave dhe lirive të qytetarëve të garantuara me Kushtetutë, dhe
- » **E dyta**, sipas organizatave fetare, ekzistojnë kriteret objektive për të përcaktuar nëse një qytetar i përket besimit fetar të krishterë apo islam.

Gjykatësit Kushtetues në vendim kanë konkluduar se ishte e nevojshme që patjetër të vërtetohen faktet objektive të një personi se i përket një feje të caktuar.

Duke vepruar kështu, ata kanë analizuar deklaratat e kërkuarit dhe kanë zbuluar se besimet e tij fetare nuk përkonin me religjionin islam. Mbi këtë bazë, Gjykata Kushtetuese konkludoi që Gjykata e Apelit në Manastir me aktgjykimin e sjellë nuk e ka diskriminuar Vasko Koteskin në baza fetare.

Nga ajo që u tha më sipër, mund të konkludohet se në **RMV, qytetarët duhet të dëshmojnë përkatësinë e tyre përmes fakteve të caktuara objektive, dhe jo vetëm në bazë të paraqitjes së një dëshmi/deklarate se i përkasin një feje të caktuar.** Faktet e tilla objektive mund të jenë:

- » **E para**, përmes dhënies së dëshmive/deklaratave se i njohin vlerat themelore teologjike të fesë përkatëse;
- » **E dyta**, paraqitja në mënyrë faktike e dokumentit ose aktit tjetër nga organizata fetare përkatëse se është pikërisht personi që i përket, dhe
- » **E treta**, provat tjera materiale që padyshim që do të çojnë në përfundimin se personi përkatës është anëtar i fesë përkatëse.

3.2. KTHIMI I PRONËS – DENACIONALIZIMI

Një nga faktorët thelbësorë që përcaktojnë marrëdhëniet e Republikës së Maqedonisë së Veriut ndaj organizatave fetare është çështja e kthimit të pronave komuniteteve dhe organizatave fetare (denacionalizimi).

Në sistemin e mëparshëm, në kohën kur Maqedonia ishte pjesë e RSFJ-së, ekzistonin proceset e konfiskimit të pasurisë së kishës nga Federata, pra nga Republika Socialiste e Maqedonisë. Me proceset e tilla iu dha një goditje e fortë religjioneve, objekteve dhe organizatave fetare.

Me pavarësinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut si shtet i pavarur dhe demokratik, çështja e kthimit të pronave qe vënë si prioritet në kuptim të korrigjimit të kësaj padrejtësie historike.

Ligji i parë për denacionalizimin u miratua më 29 prill të vitit 1998⁷⁶. Në këtë mënyrë, organizatat fetare u përjashtuan nga procesi i denacionalizimit, sepse neni 1⁷⁷ përcaktonte që prona do t'u kthehej personave fizikë, të cilët janë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Kjo gjendje u korrigjua me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Denacionalizim të miratuar më 20 prillit të vitit 2000⁷⁸, kur u bënë ndryshime konkrete. Ndërsa, me nenin 1-a qe zgjeruar fusha e denacionalizimit, ndër të tjera, edhe për organizatat fetare. Ky nen parashikonte kthimin e të gjitha pronave për organizatat fetare, por nëse nuk do të ishte e mundur, qe parashikuar të sigurohej kompensim adekuat për personat fizikë, dhe tempujt fetarë, manastiret dhe vakëfet e konfiskuar pas 2 gushtit të vitit 1944 në bazë të:

1. dispozitave që rregullojnë konfiskimin e përgjithshëm dhe kufizimin e pronësisë;
2. dispozitave për sekuestrimin e pronës për qëllime të përgjithshme, si dhe pronat e shpronësuara për qëllime të përgjithshme, pra, për interes të përgjithshëm nëse nuk plotësohen kushtet për kthimin e pronës sipas parashikimeve të shpronësimit, dhe
3. pa ndonjë bazë juridike.

76 *Ligji për denacionalizim*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, viti: LIV, nr.: 20, 29.4.1998, f.: 1086-1091.

77 *Ligji për denacionalizim*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, viti: LIV, nr.: 20, op.cit.

78 *Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për denacionalizim*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, viti: LVI, nr.: 31, 20.4.2000, f.: 1828-1830.

Me rëndësi të veçantë në këtë drejtim ishte edhe neni 1-b i ligjit që përcaktonte kategoritë “tempull fetar” (që nënkupton kishën dhe shtëpinë e lutjeve, xhaminë dhe sinagogën hebraike), si dhe “*vakëfin fetar*” (që do të thotë pronë e patjetërsueshme e destinuar për qëllime religjioze dhe humane).

Me rëndësi të veçantë për organizatat fetare ishte kapitulli IV, me titull “Dispozita të veçanta”, i cili kishte të bënte me kthimin e pronave hebraike në Maqedoninë e Veriut. Sipas ligjit, objekt i denacionalizimit ishin pronat e hebrenjve nga Maqedonia e Veriut, që kishin lënë pronat me dëbimin e tyre të detyruar në kampet fashiste, nuk i mbijetuan ndjekjes së organizuar dhe nuk kishin trashëgimtarë (neni 63-a).

Lidhur me procedurën e kthimit të pronës, dmth. kompensimit në rast se prona nuk mund të rikthehet, organi i denacionalizimit do ta iniciojë zyrtarisht sapo të bëhet e ditur se një pronë e tillë ka ekzistuar dhe në këtë procedurë mund të përfshihet drejtpërdrejt Bashkësia e Hebrenjve nga RMV-ja (neni 63-b).

Prona e kthyer, përkatësisht kompensimi i dhënë në përputhje me ligjin hyn në përbërjen e Fondit të Hebrenjve të Maqedonisë së Veriut, i cili ka fituar statusin e personit juridik. Me të sipas ligjit udhëheq këshilli drejtues i përbërë nga një numër i barabartë i përfaqësuesve të caktuar nga Qeveria e RMV-së dhe Bashkësia Hebraike e RMV-së (neni 63-c).

Në nenin 63-d të ligjit parashihet që mjetet e Fondit mund të përdoren për ndërtimin e shtëpisë së Holokaustit të hebrenjve në Maqedoni.

Me miratimin e ndryshimeve në Ligjin për denacionalizim në vitin 2000, RMV përfundimisht korrigjoi padrejtësinë historike, midis tjerash, edhe ndaj organizatave fetare. **Kthimi i pronës, në bazë të këtij ligji konsiderohet si faktor i rëndësishëm në përcaktimin e realitetit të ri demokratik në shtet.** Padrejtësitë e mëdha të bëra gjatë kohës së sistemit socialist në të kaluarën nuk mund të korrigjoheshin plotësisht, megjithatë besohet se me procesin e demokratizimit, si dhe me denacionalizimin e pronës së organizatave fetare, shteti arriti të mbyllë një çështje të hidhur në historinë e fundit të Maqedonisë së Veriut.

3.3. MBROJTJA NGA DISKRIMINIMI FETAR

Kushtetuta përcakton liritë dhe të drejtat themelore të individit dhe qytetarit të njohur në të drejtën ndërkombëtare dhe të përcaktuara me aktin më të lartë juridik në shtet si vlera themelore të rendit kushtetues.

Liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe qytetarit zënë vend qendror në pjesën normative të aktit më të lartë juridik. Në kontekst të punës, neni 9 i Kushtetutës⁷⁹ është thelbësor, i cili përcakton që të gjithë qytetarët janë të barabartë në liritë dhe të drejtat e tyre, pavarësisht nga seksi, raca, ngjyra e lëkurës, origjina kombëtare dhe shoqërore, bindjet politike dhe fetare, pasuria dhe statusi shoqëror. Të gjithë qytetarët janë të barabartë para Kushtetutës dhe ligjit.

Kushtetuta përcakton se të drejtat dhe liritë mund të kufizohen vetëm gjatë gjendjeve të luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme, ndërsa kufizime të tilla nuk mund të diskriminojnë qytetarët për shkak të seksit, racës, ngjyrës së lëkurës, gjyhës, fesë, origjinës kombëtare ose shoqërore, pronës ose statusit shoqëror.

Mbrojtja ndaj diskriminimit bazuar në përkatësinë e një organizate fetare ose në besimet fetare rregullohet me ligje të ndryshme, të cilat mund të ndahen në dy grupe:

1. ligjet që përcaktojnë kornizën e përgjithshme për mbrojtjen nga diskriminimi, dhe
2. ligjet që përcaktojnë diskriminimin bazuar në përkatësinë e një organizate fetare ose në besimin fetar në detaje.

Korniza e përgjithshme për mbrojtje nga diskriminimi, përfshirë diskriminimin për arsye fetare, përcaktohet në Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi⁸⁰, i cili u miratua në Prill 2010. Me këtë ligj, shtetet sigurojnë parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi (neni 1) në mënyrë të barabartë për të gjithë personat juridikë dhe personat fizikë (neni 2). Në kuptimin konkret, Ligji ndalon:

1. Diskriminimin direkt ose indirekt;
2. thirrjen dhe nxitjen e diskriminimit, dhe
3. ndihmën në trajtimin diskriminues.

Mbrojtja dhe parandalimi i diskriminimit vlen për çdo qytetar, pavarësisht nga seksi, raca, ngjyra, gjinia, grupi i marginalizuar, etnia, gjuha, shtetësia, origjina shoqërore, besimet tjera, arsimit, përkatësia politike, statusi personal ose social, paaftësia mendore dhe fizike, mosha, gjendja familjare ose martesore, statusi i pronës, gjendja shëndetësore ose çfarëdo baze tjetër e parashikuar me ligj ose me marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara, përfshirë religjionin ose besimin fetar (neni 3).

79 *Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut*, Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: XLVII, nr.: 52, op.cit.

80 *Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LXVI, nr. 50, Shkup, 13.4.2010, f.: 54-66.

Baza e përcaktuar kështu, në përputhje me nenin 4, vlen jo vetëm për personat fizikë, por edhe për të gjitha organet shtetërore, organet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, personat juridikë me autorizime juridike publike dhe personat e tjerë juridikë.

Ligji përshkruan lloje të ndryshme të diskriminimit. Nga aspekti i temës së këtij punimi, janë veçanërisht të rëndësishme:

- » *Diskriminim i drejtpërdrejtë*: çdo trajtim, diferencim, përjashtim ose kufizim i pafavorshëm që rezulton ose mund të rezultojë në privim, shkelje ose kufizim të gëzimit të barabartë të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (neni 6, paragrafi 1).
- » *Diskriminimi indirekt* i cili e vë çdo person ose grup në situatë të pakëndshme në krahasim me personat ose grupet tjera përballë dispozitave, kritereve ose praktikave dukshëm neutrale, përveç nëse dispozitat, kriteret ose praktikat e tilla rrjedhin nga një qëllim i arsyeshëm dhe mjetet për të arritur këtë objektiv janë adekuate dhe të domosdoshme (neni 6, paragrafi 2).
- » *Ngacmimi dhe trajtimi poshtërues* që përfshijnë shkeljen e dinjitetit të një personi ose të një grupi që rrjedh nga baza diskriminues ose krijimi i një ambienti, qasjeje ose praktike kërcënuese, armiqësore, poshtëruese ose frikësuese (neni 7 paragrafi 1);
- » *Thirrja dhe nxitja e diskriminimit* që nënkupton çdo veprimtari me të cilën një person ose grup drejtpërdrejt ose indirekt thirret, inkurajon, jep udhëzime ose nxit një person ose grup tjetër të diskriminojë (neni 9);
- » *Viktimizimi* i cili nënkupton një sjellje të pakëndshme ndaj një personi, përfshirë vuajtjen e pasojave të dëmshme për ndërmarrjen e aktiviteteve për mbrojtje nga diskriminimi (neni 10), si dhe
- » *Format më të rënda diskriminimit*, që do të thotë diskriminim ndaj një personi mbi baza të shumta (diskriminim i shumëfishtë), diskriminimi në mënyrë të përsëritur (diskriminim i përsëritur), i cili është bërë për një kohë të gjatë (diskriminim i vazhdueshëm) i cili, me pasojat e tij, prek veçanërisht personin e diskriminuar (neni 12).

Ligji, gjithashtu, përfshinë dispozitat që lidhen me çështjen e përjashtimeve nga diskriminimi. Përjashtimet e mëposhtme janë me rëndësi të veçantë:

1. trajtimi i ndryshëm të personave që nuk janë shtetas të RMV-së në lidhje me liritë dhe të drejtat e përcaktuara në Kushtetutë, në ligjet dhe marrëveshjet ndërkombëtare, në të cilat ka aderuar vendi ynë, dhe që rrjedhin drejtpërdrejt nga shtetësia e RMV-së (neni 14 pika 1)

2. trajtimi i ndryshëm i personave mbi bazën e religjionit, besimit, seksit ose karakteristikave të tjera në lidhje me një profesion që zhvillohet në institucione ose organizata religjioze kur, për nga natyra e një profesioni të veçantë ose për shkak të kushteve në të cilat ushtrohet religjioni, besimi, seksi ose karakteristika të tjera paraqesin kërkesë thelbësore, nga pikëpamja e institucionit ose organizatës, kur qëllimi është legjitim dhe kushti nuk e tejkalon nivelin e kërkuar për zbatim (neni 14 alineja 3)
3. trajtimi i ndryshëm i ndryshëm i personave mbi bazën e religjionit, besimit, seksit ose karakteristikave të tjera në lidhje me edukimin dhe aftësimin për qëllime të profesionit në lidhje me një religjion konkret (neni 14 pika 4);
4. nëse anëtarët dhe organet e kishave dhe bashkësive fetare, organizatat e shoqërisë civile, partitë politike, sindikatat dhe organizatat e tjera të regjistruara veprojnë në përputhje me doktrinën, bindjet ose besimet e tyre ose qëllimet e përcaktuara në statutet, programet ose dispozitat e tyre (neni 14, alineja 5);
5. rregullimi i martesës, bashkësisë jashtëmartesore dhe familjes vetëm si një bashkësi e gjinive të kundërta, d.m.th. të një burri dhe një gruaje (neni 14, alineja 6);
6. ushtrimi i parimit të garantuar me kushtetutë i lirisë së fjalës, paraqitjes në publik, mendimit dhe informacionit publik (neni 14 alineja 7), si dhe
7. masat për mbrojtjen e tipareve dhe identiteteve të veçanta të personave që u përkasin pakicave etnike, fetare ose gjuhësore dhe të drejtën e tyre për të nxitur dhe zhvilluar identitetin e tyre, individualisht ose me anëtarët e tjerë të grupit të tyre, si dhe stimulojnë kushtet për promovimin e këtij identiteti (Neni 15, paragrafi 8).

Përveç këtij sistemi të mbrojtjes nga diskriminimi, Ligji përmban dispozita që sigurojnë bazën ligjore për krijimin e Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili është përgjegjës për zbatimin e dispozitave të Ligjit.

Nga ligjet e veçanta të Republikës së Maqedonisë së Veriut që sigurojnë mbrojtje të qytetarëve nga diskriminimi, veçanërisht bazuar në përkatësinë fetare, dallojmë aktet e mëposhtme më të rëndësishme:

» *Kodin Penal*⁸¹, ku çështja e mos-diskriminimit, bazuar, d.m.th., në përkatësinë fetare ose besimin referohet në tre nene:

1. Në Kapitullin 15, i cili ka të bëjë me veprat penale kundër lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të qytetarit, në nenin 137 theksohet se ai që për shkak të

81 *Kodi Penal*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë viti: LII, nr.: 37, Shkup, 29.7.1996, f.: 1522-1574.

dallimit të seksit, racës, ngjyrës së lëkurës, origjinës kombëtare dhe sociale, bindjes politike, gjendjes pronësore dhe shoqërore, gjuhës, apo pronës ose rrethanave të tjera personale, përfshirë bindjen fetare, privohet ose i kufizohen të drejtat e individit dhe qytetarit, të përcaktuara me Kushtetutë, ligj ose marrëveshje të ratifikuar ndërkombëtare, ose të cilët në bazë të këtyre dallimeve u japin qytetarëve privilegje në kundërshtim me Kushtetutën, ligjin ose marrëveshjen e ratifikuar ndërkombëtare, dënohet me burgim nga tre muaj deri në tre vjet.

2. Në kapitullin 28, i cili merret me veprat penale kundër shtetit, neni 319 përcakton se ai që me detyrim, maltretim, rrezikim të sigurisë, tallje të simboleve kombëtare, etnike ose fetare, duke dëmtuar objekte të huaja, shkatërrimin e monumenteve, varreve ose në një mënyrë tjetër do të shkaktojë ose nxisë mosdurim kombëtar, racor, përfshirë edhe urrejtjen, përçarjen ose mosdurimin fetar, do të dënohet me burg nga një deri në pesë vjet.
3. Në kapitullin 44, i cili ka të bëjë me veprat penale kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare, neni 403 përcakton se çdo person që synon, tërësisht ose pjesërisht, të shkatërrojë një grup nacional, etnik, racor, përfshirë edhe grupin fetar, urdhëron të bëhen vrasje ose lëndime të rënda trupore, ose dëmtime serioze të shëndetit fizik ose mendor të anëtarëve të grupit ose shpërnguljen me dhunë të popullatës ose grupit dhe të vihen në kushte të tilla jetese që çojnë në shkatërrimin e plotë ose të pjesshëm të grupit ose zbatojnë masa për pengimin e lindjeve në mesin e anëtarëve të grupit, ose përbëjnë shpërnguljen e detyruar të fëmijëve të një grupi tjetër, ose ai që me të njëjtin qëllim, kryen ndonjë nga veprat e mëposhtme dënohet me burgim së paku dhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

» *Ligji për Gjykatat*⁸² përcakton se të gjithë kanë të drejtë të kenë qasje të barabartë para gjykatave në mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe interesave të bazuara në ligj (neni 6). Në zgjedhjen e gjykatësve dhe gjykatësve porotë, në përputhje me ligjin, nuk guxon të ketë diskriminim në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës, origjinës kombëtare ose sociale, gjendjes pronësore ose shoqërore, bindjes politike ose fetare (neni 43 paragraf 1).

» *Ligji për Prokurorinë Publike*⁸³. Ky akt përcakton se "prokurori publik në ushtrimin e funksionit të vet siguron barazi para ligjit pavarësisht seksit, racës, ngjyrës, origjinës kombëtare dhe sociale, gjendjes pronësore dhe shoqërore, bindjeve politike ose

82 *Ligji për gjykatat*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LXII, nr.: 58, Shkup, 11.5.2006, f.: 1-26.

83 *Ligji për prokurorinë publike*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LXIII, nr.: 150, Shkup, 12.12.2007, f.: 41-68.

fetare (neni 5 paragrafi 2). Ligji, gjithashtu ndalon në mënyrë të qartë diskriminimin në zgjedhjen e një prokurori publik dhe garanton parimin e përfaqësimit të drejtë (neni 43).

» *Ligji për ekzekutimin e sanksioneve*⁸⁴. Ky akt e ndalon diskriminimin në bazë të racës, ngjyrës së lëkurës, seksit, gjuhës, fesë, bindjeve politike ose të tjera, origjinës kombëtare ose sociale, farefisnisë, statusit pronësor ose shoqëror ose ndonjë statusi tjetër të personit të cilit i është shqiptuar sanksioni. Duhet të respektohen ndjenjat fetare, besimet personale dhe normat morale ndaj shkelësve (neni 4 paragrafi 2 dhe 3). Për këtë qëllim, Ligji përcakton gjithashtu që zyrtarët duhet të kryejnë detyrat e tyre me ndershmëri dhe paanshmëri, pa ligësi dhe qëllim të keq, pa marrë parasysh pozicionin, seksin, racën, kombësinë, fenë ose bindjet politike të të dënuarve (neni 163, paragrafi 2).

» *Ligji për punë të brendshme*⁸⁵. Në këtë Akt, në kapitullin që ka të bëjë me dispozitat e përgjithshme, në nenin 2 alineja 4, i cili përcakton kategorinë e “punëve të brendshme” është parashikuar që punët e brendshme të përbëjnë, ndër të tjera, pengimin e nxitjes së mosdurimit nacional, racor, përfshirë edhe urrejtjen dhe mosdurimin fetar.

» *Ligji për Mbrojtjen Sociale*⁸⁶ ndalon në mënyrë të qartë diskriminimin e drejtpërdrejtë ose indirekt në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës, përkatësisë kombëtare, shoqërore, politike, fetare, pronësore dhe shoqërore. Ligji thotë që një ndalim i tillë zbatohet në mënyrë të barabartë për institucionet publike të mbrojtjes sociale të themeluara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, komunat, qyteti i Shkupit, institucionet private të mbrojtjes sociale të formuara nga persona juridikë ose fizikë, si dhe shoqatat e qytetarëve dhe personave fizikë që kryejnë punë në fushën e mbrojtjes sociale (neni 20).

» *Ligji për partitë politike*⁸⁷. Ky Akt, në pjesën hyrëse, në nenin 3, alineja 3, ndër të tjera, përcakton se programi, statuti dhe programi i partive politike nuk mund të jenë të drejtuara për nxitje kombëtare, racore, përfshirë edhe urrejtjen dhe mosdurimin fetar.

84 *Ligji për ekzekutimin e sanksioneve*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti. LXII, nr.: 2, Shkup, 9.1.2006, f.: 2-63.

85 *Ligji për punë të brendshme*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LXV, nr. 92, Shkup, 24.7.2009, f.: 4-42.

86 *Ligji për mbrojtjen sociale*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LXV, nr.: 79, Shkup, 24.6.2009, f.: 11-67.

87 *Ligji për partitë politike*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti. LX, nr.: 76, Shkup, 27.10.2004, f. 1-9.

» *Ligji për shoqatat dhe fondacionet*⁸⁸. Ky akt përfshin dy dispozita për mbrojtjen kundër diskriminimit dhe mbi baza fetare. Në nenin 4, paragrafi 2 përcaktohet se themelimi i një organizate ndalohet nëse programi dhe veprimi i tij kanë për qëllim prishjen me dhunë të rendit kushtetues të RMV-së, nxitjen dhe thirrjen e agresionit ushtarak dhe nxitjen e urrejtjes dhe mosdurimit kombëtar, racor, përfshirë edhe urrejtjen dhe mosdurimin fetar, ndërmarrjen e veprimtarive që janë në kundërshtim me Kushtetutën ose ligjin dhe shkelin liritë dhe të drejtat e të tjerëve. Neni 65, alineja 2, për ndalimin e punës së një shoqate ose fondacioni tashmë të regjistruar, përcakton ndalimin e punës së një organizate nëse ajo gjatë punës së saj nxit urrejtje dhe mosdurim fetar.

» *Ligji për marrëdhënie të punës*⁸⁹. Ky akt gjithashtu përmban një dispozitë në lidhje me çështjen e mosdiskriminimit. Ndërsa, në nenin 6 paragrafi 1 është parashikuar që punëdhënësi nuk duhet ta vë aplikuesin për punësim ose punonjësin në një pozitë të pabarabartë për shkak të origjinës racore ose etnike, ngjyrës së lëkurës, gjinisë, moshës, gjendjes shëndetësore ose aftësisë së kufizuar, politike, përfshirë bindjen fetare ose bindjen tjetër.

» *Ligji për arsimin e mesëm*⁹⁰. Në këtë akt, çështja e mosdiskriminimit është rregulluar me nenin 3, i cili përcakton që të gjithë, në kushte të barabarta të parashikuara me ligj, kanë të drejtë në arsimin e mesëm dhe se nuk lejohet asnjë diskriminim në bazë të gjinisë, racës, ngjyrës, origjinës kombëtare ose sociale, bindjes politike, statusit pronësor dhe shoqëror, si dhe bindjes fetare.

» *Ligji për kulturën*⁹¹. Në këtë akt, çështjet që lidhen me mosdiskriminimin në kulturë rregullohen me nenin 3, i cili përcakton se të gjithë kanë të drejtë pavarësisht nga mosha, arsimi, feja, përkatësia etnike ose përkatësia tjetër, në krijimtarinë e lirë, joprofesionale ose profesionale, si dhe të drejtë për edukimi nga fusha e kulturës.

3.4. E DREJTA E KUNDËRSHTIMIT TË NDËRGJEGJES

E drejta për kundërshtim të ndërgjegjes rrjedh nga **liria e bindjes personale, ndërgjegjja dhe mendimi, dhe liria fetare**. Ajo lejon që një person të lirohet nga

88 *Ligji për shoqatat dhe fondacionet*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LXVI, nr.: 52, Shkup, 16.4.2010, f. 2-26.

89 *Ligji për marrëdhënie të punës*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LXVI, nr.: 158, Shkup, 9.12.2010, f.: 144-185.

90 *Ligji për arsimin e mesëm*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LVIII, nr.: 52, Shkup, 10.7.2002, f.:10-20.

91 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë, *Aktvendimi u.nr. 37/2002-0-1*, Shkup, 26.6.2002.

disa detyra ligjore, sepse ato bien ndesh me bindjet e tyre fetare, morale, filozofike ose humanitare⁹².

Kundërshtimi i ndërgjegjes prek kryesisht sferën e mbrojtjes, ku, në rrethana të caktuara, një person mund të kërkojë (dhe shteti mund t'u lejojë) përjashtim nga detyra civile e shërbimit ushtarak, d.m.th shteti mund të sigurojë rrethana të përshtatshme që personat e tillë të ushtrojnë të drejtën e tyre, por edhe obligimin e tyre për mbrojtjen e shtetit në një mënyrë që nuk bie ndesh me bindjet e tyre intime, personale⁹³.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, e drejta për kundërshtim të ndërgjegjes u fut në Ligjin e parë për Mbrojtjen më 1992⁹⁴ dhe u përforcua në Ligjin e dytë në vitin 2001⁹⁵, përfundimisht me ndryshimet ligjore në vitin 2006⁹⁶, kur u shfuqizua shërbimi i detyrueshëm ushtarak, d.m.th u aplikua koncepti i ushtrisë profesionale.

Ndërkohë, veçanërisht pas miratimit të ligjit në vitin 2001, Gjykata Kushtetuese debatoi për shumë iniciativa që lidhen me ushtrimin e kësaj të drejte dhe është përgjigjur në mënyrë përkatëse.

Të gjitha ligjet, si dhe aktvendimet dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese, formësuan konceptin e kundërshtimit të ndërgjegjes brenda sistemit kushtetues dhe juridik të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Çështja e kundërshtimit të ndërgjegjes ishte rregulluar në mënyrë rudimentare nga Ligji i parë për Mbrojtjen, pa u përmendur qartë. Neni 7, paragrafi 1⁹⁷ përcakton që kohëzgjatja e shërbimit ushtarak me Forcat e Armatosura është nëntë muaj, ndërsa paragrafi 2 i të njëjtit nen thotë se ushtarët që nuk duan të mbajnë armë kryejnë shërbimin ushtarak në kohëzgjatje prej 14 muajsh.

Krahasuar me dispozitat ligjore, përkufizimi i kundërshtimit të ndërgjegjes të hartuar nga Gjykata Kushtetuese në vitin 2001 çon në përfundimin se zbatimi praktik i kësaj të drejte është mjaft i kufizuar, dhe se ajo mund të ushtrohet në bazë fetare, por jo edhe morale, filozofike ose humanitare. Përveç kësaj, Ligji nuk përfshin ndonjë

92 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë, *Aktvendimi u.nr. 37/2002-0-1*, op.cit.

93 *Ligji për mbrojtje*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: XLVIII, nr.: 8, Shkup, 2/15/1992, f.: 85-96.

94 *Ligji për mbrojtje*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LVII, nr.: 42, Shkup, 1.6.2001, f.: 3128-3144.

95 *Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtje*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LXII, nr.: 58, Shkup, 11.5.2006, f.: 26-29.

96 *Ligji për mbrojtje*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: XLVIII, nr.: 8, op.cit.

97 Ibid.

dispozitë në lidhje me procedurën e ushtrimit të së drejtës për kundërshtim të ndërgjegjes, një fakt që duhet të ketë pasur ndikimin e tij në zbatimin praktik.

Në Ligjin e dytë për Mbrojtje, çështja e kundërshtimit të ndërgjegjes trajtohet në mënyrë më të detajuar. Neni 7⁹⁸ përcakton se shërbimi ushtarak zgjat nëntë muaj (paragrafi 1) dhe se ky obligim kryhet në Armatë (paragrafi 2). Ndërsa neni 8 përcakton që rekrutët të cilët, bazuar në bindjet e tyre fetare ose morale (kundërshtimi i ndërgjegjes), nuk duan të shërbejnë me Forcat e Armatosura, kanë dy alternativa:

1. të kryejë shërbimin ushtarak në ARM pa armë, ose
2. të kryejë shërbimin ushtarak në shërbimin civil për një periudhë prej 14 muajsh, në bazë të ligjit të mëparshëm të vitit 1992.

Neni 10 i Ligjit thotë se, për të ushtruar të drejtën e kundërshtimit të ndërgjegjes, rekrutët duhet të paraqesin një kërkesë me shkrim duke deklaruar arsyet e tyre në Ministrinë e Mbrojtjes brenda 15 ditëve pasi të marrin thirrjen e tyre të rekrutimit, për të cilën do të marrin përgjigje brenda 60 ditëve. Rekruti ka të drejtë të paraqesë ankesë kundër vendimit të Ministrisë së Mbrojtjes pranë komisionit kompetent të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në Ligjin e dytë për Mbrojtjen, fushëveprimi dhe vetë procedura e kundërshtimit të ndërgjegjes përcaktohet më hollësisht. Por, fusha e veprimit kufizohet vetëm për rekrutët, në mënyrë që të mos zbatohet për asnjë anëtar tjetër të Forcave të Armatosura të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Ky fakt, ishte ndër arsyet për të paktën shtatë iniciativat e paraqitura në Gjykatën Kushtetuese midis vitit 2002 dhe 2004, në lidhje me dispozitat që rregullojnë të drejtën për kundërshtime të ndërgjegjes, në njërën prej të cilave kushtetues dhanë mendim pozitiv⁹⁹.

Iniciativa që paraqitur kundër nenit 10 paragrafi 1 të Ligjit, i cili thotë:

“Rekruti që dëshiron të kryejë shërbimin ushtarak, në përputhje me nenin 8 të këtij ligji, bën kërkesë me shkrim në Ministrinë e Mbrojtjes brenda 15 ditëve nga marrja e ftesës për rekrutim, duke deklaruar arsyet e tij dhe mënyrën se si dëshiron ta kryejë shërbimin”.

98 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë, *Vendimi, u.nr. 37/2002-0-0*, 12.9.2002.

99 *Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtje*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LXII, nr.: 58, op.cit.

Në vendimin në lidhje me iniciativën, Gjykata Kushtetuese përcaktoi kufijtë e së drejtës për kundërshtim të ndërgjegjshëm duke iu referuar neneve të Kushtetutës që kanë të bëjnë me çështjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, dhe veçanërisht nenit 8 alineja 1, sipas të cilit të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe qytetarit të njohura në të drejtën ndërkombëtare dhe të përcaktuara me Kushtetutë paraqesin një nga vlerat themelore mbi të cilat mbështetet sistemi kushtetues i shtetit; neni 16, paragrafi 1, i cili garanton lirinë e besimit, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimit; neni 19, paragrafët 1 dhe 2, sipas të cilit Kushtetuta garanton lirinë e fesë dhe shprehjen e fesë në mënyrë të lirë dhe publike, individualisht ose në bashkësi me të; si dhe nenin 54 paragrafët 1 dhe 3 me të cilin liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të qytetarit mund të kufizohen vetëm në rastet e përcaktuara me Kushtetutë dhe se kufizimi i lirive dhe të drejtave nuk mund të jetë diskriminues për shkak të seksit, racës, ngjyrës së lëkurës, gjuhës, fesë, origjinë kombëtare ose sociale, gjendjes pronësore ose shoqërore.

Bazuar në dispozitat kushtetuese të mësipërme, Gjykata Kushtetuese hartoi katër kritere për të kuptuar juridikisht kuptimin dhe fushën e së drejtës për kundërshtim të ndërgjegjës brenda sistemit kushtetues dhe juridik të Republikës së Maqedonisë së Veriut:

1. kundërshtimi i ndërgjegjës është e drejtë imanente që rrjedh nga liria e besimit, ndërgjegjes, mendimit dhe lirisë së fesë;
2. kundërshtimi i ndërgjegjës është mjet me të cilin bartësi i kësaj të drejte mund të shmangë detyrime të caktuara ligjore, sepse përmbushja e tyre bie ndesh me bindjet e tij fetare, morale, filozofike ose humanitare;
3. kundërshtimi i ndërgjegjës në sferën mbrojtjes bëhet atëherë kur persona të caktuar dhe në kushte të caktuara rreptësisht mund të kërkojnë dhe shteti t'u lejojë të lirohen nga shërbimi civil që të kryejnë shërbimin ushtarak, që nuk do të thotë që këta persona janë plotësisht të liruar nga ky obligim;
4. kundërshtimi ndaj ndërgjegjës është shfaqje e jashtme e lirisë së mendimit, ndërgjegjes dhe fesë, ku kjo e drejtë përfshinë edhe lirinë e ndërrimit të fesë dhe besimit. Prandaj, nuk ka dyshim se liria përfshin krijimin, ndryshimin dhe braktisjen e perceptimeve të caktuara personale, bindjeve morale ose fetare. Ajo që në një moment është e pranueshme për ndërgjegjen dhe bindjen njerëzore, nuk do të thotë se është e përhershme dhe se nuk mund të pësojë modifikime dhe ndryshime përkatëse me kalimin e kohës.

Bazuar në këtë kornizë ligjore, dhe duke pasur parasysh diktimin e nenit të diskutueshëm 10, Gjykata Kushtetuese arriti në përfundimin se e drejta për kundërshtim të ndërgjegjës u ishte dhënë vetëm rekrutëve, por jo edhe të obliguesve ushtarakë, ushtarëve ose rekrutëve rezervë.

Gjykatësit kushtetues arritën në përfundimin se dispozita ligjore përcakton lirinë e ndërgjegjes dhe besimit të shprehur në të drejtën e kundërshtimit të ndërgjegjes si diçka të pandryshueshme, sepse ligji e lidh ushtrimin e tij me një periudhë kohe pas së cilës nuk mund të ushtrohet më.

Gjykata Kushtetuese vlerësoi se ky ishte një kufizim i së drejtës për faktin se ankesa mund të bëhej vetëm një herë në jetë, dhe për shkak të kësaj rrethane Gjykata vendosi të shfuqizojë nenin 10 paragrafi 1 të Ligjit të Mbrojtjes.

Në vitin 2006, në lidhje me të drejtën e kundërshtimit të ndërgjegjes, Parlamenti i RMV-së miratoi disa ndryshime në Ligjin për mbrojtje¹⁰⁰ që shfuqizuan shërbimin ushtarak, përkatësisht ka aplikuar konceptin e ushtrisë profesionale.

Kështu, hapësira për të ushtruar të drejtën e kundërshtimit të ndërgjegjes është zvogëluar dukshëm (përdoret kryesisht nga ushtarët e rekrutuar), por nuk është zhdukur plotësisht duke pasur parasysh që ligji i mbrojtjes rregullon edhe çështjet e mobilizimit të popullatës. Përveç kësaj, me vendimin e Gjykatës Kushtetuese që përcaktuar se kjo e drejtë mund të përdoret në raste të tjera.

Mbetet e panjohur se si e drejta për kundërshtim të ndërgjegjes, e cila buron nga dispozitat e lartpërmendura kushtetuese dhe ligjore dhe që, në fakt, mund të zbatohet edhe për raste të tjera, veçanërisht çështja e mobilizimit në kontekstin e nenit 28 të Kushtetutës, i cili thotë se mbrojtja e Republikës së Maqedonisë së Veriut është e drejtë dhe detyrë e çdo qytetari.

3.5. EDUKIMI FETAR

Në kontekstin e debatit të vazhdueshëm të gjerë mbi kufijtë e shekullarizmit, mësimbesimi në shkollat fillore shtetërore është një nga pengesat kryesore.

Baza për rregullimin e pozitës së Republikës së Maqedonisë së Veriut për çështjen e mësimëve fetare në shkollat fillore sigurohet nga Kushtetuta, ku neni 44 përcakton se arsimit fillor është i detyrueshëm dhe falas, dhe neni 45, se qytetarët kanë të drejtë të themelojnë shkolla private në të gjitha nivelet e arsimit, me përjashtim të arsimit fillor, nën kushtet e përcaktuara me ligj. Këto dispozita kushtetuese mbështeten me ligjet për arsimin fillor që janë miratuar ndër vite.

¹⁰⁰ *Ligji për arsimin fillor*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LI, nr.: 44, Shkup, 20.9.1995, f.: 1129-1137.

Që nga pavarësia e RMV-së e deri më sot, rregullimi i çështjes është shoqëruar me paqartësi ligjore, duke rezultuar në disa përpjekje për futjen e mësimit fetar.

Në mënyrë kronologjike, mund të identifikohen **5 faza**:

1. nga viti 1991 deri më 2002: mësimi fetar nuk është lëndë në shkollat fillore;
2. nga viti 2002 deri më 2003: mësimi fetar mësohet si lëndë mësimore në shkollat fillore;
3. **Periodha e tretë** nga viti 2003 deri më 2008: mësimbesimi, përsëri nuk zhvillohet në arsimin fillor;
4. nga viti 2008 deri më 2009: mësimbesimi, përsëri, zhvillohet si lëndë mësimit;
5. nga viti 2009: feja nuk u mësohet, por është futur një formë e edukimit religjioz.

Faza e parë bazohet në Ligjin e parë mbi arsimin fillor, miratuar më 1995¹⁰¹. Neni 13 i tij parashikon dy ndalime të qarta në shkollat fillore:

1. ndalohet organizimi fetar dhe politik, dhe
2. ndalohet zhvillimi i mësimit fetar.

Kjo gjendje u ndryshua në vitin 2002, kur ministri i Arsimit me një akt nënligjor¹⁰² futi lëndën e mësimbesimit si lëndë me zgjedhje në klasën e tretë të shkollës fillore.

Një vit më vonë, në nëntor të vitit 2003, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut, bazuar në iniciativën e një qytetari, solli vendim për shfuqizimin e *Aktvendimit të Ministrisë të Arsimit*¹⁰³, duke filluar kështu fazën e tretë, ku feja, përsëri, nuk mësohet në arsimin fillor.

Gjykata Kushtetuese solli gjithashtu një vendim me të cilin, për herë të parë, u mor me interpretimin praktik të dispozitave kushtetuese dhe ligjore mbi çështjen e mësimbesimit.

Analiza e vendimit vë në spikamë të paktën 3 interpretime ligjore:

1. Shteti nuk mund të imponojë asnjë lloj aktiviteti fetar për qytetarët e vet.
2. Shteti duhet të mbajë neutralitetin në mënyrë që qytetarët të përcaktohen lirshëm nëse do të pranojnë një fe të caktuar, nëse do ta praktikojnë atë apo jo, dhe nëse do të marrin pjesë në ritualet fetare apo jo, që përfshin lirinë e qytetarëve për të vendosur nëse do t'i studiojë librat e shenjtë të fesë me të cilat janë të lidhur, si dhe të grupeve të tjera religjioze, dhe

101 Ligji për arsimin fillor, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, LI, nr. 44, Shkup, 20.9.1995, f. 1129-1137.

102 Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut, *Aktvendimi nr.: 10-2858 / 1*, Shkup, 3.10.2002.

103 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut, *Aktvendimi nr.: 42 / 2003-0-0*, Shkup, 5.11.2003.

3. Qytetarët kanë mundësinë të përfshihen në të gjitha aktivitetet e përmendura në lidhje me përcaktimin e përkatësisë fetare dhe njohjen me besimet e çdo grupi fetar duke studiuar librat e tyre të shenjtë brenda dhe jashtë komuniteteve fetare, por jo brenda organeve shtetërore dhe institucioneve publike siç janë shkollat.

Pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, në vitin 2008, solli një Ligj të ri mbi Arsimin Fillor¹⁰⁴. Neni 26 i tij përcakton që ësimbesimi mund të futet si lëndë me zgjedhje në shkollat fillore. Sipas dispozitave kalimtare dhe përfundimtare të ligjit, neni 26 do të hynte në fuqi më 1 shtator të vitit 2008, ditën e parë të vitit të ri shkollor.

Ky vendim shënoi fillimin e fazës së katërt, dhe në dallim nga aplikimi i mëparshëm i mësimbesimit, kësaj radhe u bë jo me një akt nënligjor, por me ligj.

Në prill të vitit 2009, kur Gjykata Kushtetuese e RMV-së, duke debatuar mbi iniciativën e një partie politike, filloi procedurën¹⁰⁵ për vlerësimin e kushtetutshmërisë së nenit 26 të Ligjit për arsimin fillor¹⁰⁶, i cili përfundon me miratimin e një Vendimi¹⁰⁷ që shfuqizon nenin 26, përkatësisht ndalon mësimbesimin në arsimin fillor. Ky vendim shënon fillimin e fazës së pestë.

Sipas mendimit të Gjykatës Kushtetuese, shfuqizimi i nenit 26 të Ligjit për arsimin fillor është bërë nga fakti se:

1. Të gjithë qytetarët janë të barabartë në liritë dhe të drejtat e tyre;
2. Të gjithë qytetarëve u garantohet liria e shprehjes fetare;
3. Bashkësitë fetare dhe grupet religjioze janë të ndara nga shteti dhe janë të barabartë para ligjit;
4. Bashkësitë fetare dhe grupet religjioze janë të lira të themelojnë shkolla fetare dhe institucione të tjera sociale dhe bamirëse;
5. Liria për t'u lidhur me një fe të caktuar përfshin të drejtën për të mos qenë e lidhur ose për të studiuar ndonjë fe.
6. Nuk ka fe shtetërore dhe fe të privilegjuar për çfarëdo arsye;
7. **E shtata**, ekziston liria e bashkimit të qytetarëve për ushtrimin e bindjeve të tyre bazuar në programe dhe veprime që, ndër të tjera, nuk janë të drejtuara në urrejtje fetare dhe intolerancë.

104 *Ligji për arsimin fillor*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LXIV, nr.: 103, Shkup, 19.8.2008, f.: 3-44.

105 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Aktvendimi nr. 202 / 2008-0-0, Shkup, 11.2.2009.

106 *Ligji për arsimin fillor*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LXIV, nr.: 103, op.cit.

107 *Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut*, Aktvendimi nr. 202 / 2008-0-1, Shkup, 15.4.2009.

Gjykata Kushtetuese në mënyrë plotësuese ka precizuar mendimin juridik lidhur me kufijtë e shekullarizmit në sistemin arsimor të RMV-së përmes çështjes së edukimit fetar. Sipas gjykatësve, futja e arsimit fetar në arsimin publik tejkalon karakterin akademik dhe neutral të mësimdhënies, që është karakteristikë për arsimin publik, shtetëror dhe përfshin shtetin në organizimin e mësimit fetar, i cili është në kundërshtim me parimin kushtetues të ndarjes së shtetit dhe kishës.

Nga ana tjetër, Gjykata thekson hapësirën e lirë të bashkësive fetare për të themeluar shkolla fetare si e drejtë e garantuar me kushtetutë.

Nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese, mund të konkludojmë se Republika e Maqedonisë së Veriut është shtet **shekullar, i cili siguron neutralitetin fetar të arsimit dhe se nuk lejohet të marrë përgjegjësi që janë në fushën e bashkësive fetare dhe grupeve religjioze.**

Sipas mendimit të Gjykatës Kushtetuese, studimi i aspekteve konkrete të një feje mund është përgjegjësi ekskluzive e bashkësive fetare dhe grupeve religjioze, dhe jo e institucioneve arsimore publike.

Nga ana tjetër, kjo nuk do të thotë që shteti nuk ka të drejtë të fusë një lëndë në shkollat fillore e cila do të përfshinte studimin e feve të ndryshme nga pikëpamja laike (neutrale). Në përputhje me këtë fakt, dhe bazuar në nenin 25, paragrafi 1, të Ligjit për Arsimin Fillor¹⁰⁸, i cili thotë se Ministri i Arsimit përcakton konceptin e arsimit fillor, mbi bazën e të cilit miratohen plan-programet mësimore, dhe si lëndë zgjedhore mësohet etika e religjioneve për nxënësit e klasës së 5-të, të cilët nga pikëpamja shekullare studiojnë aspektet morale të feve të njohura me Kushtetutën e RMV-së¹⁰⁹.

Gjatë historisë së fundit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, lavjerrësi i shekullarizmit në fushën e mësimave fetare në shkollat fillore ka qenë objekt i ndryshimeve të ndryshme. Duket sikur Republika e Maqedonisë së Veriut, **pas tridhjetë vjet pavarësie, më në fund ka arritur një balancë, me atë që shteti ka bërë lëshime për qytetarët që të mund t'i mësojnë fetë në arsimin fillor, por në mënyrë që nuk e rrezikon konceptin e përcaktuar kushtetues të ndarjes së shtetit nga organizatat fetare.**

108 *Ligji për arsimin fillor*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LXIV, nr.: 103, op.cit.

109 Byroja për Zhvillimin e Arsimit të Republikës së Maqedonisë, *Programi mësimor për lëndën etika e religjioneve për klasën V të arsimit fillor tetëvjeçar* (bro.gov.mk), 2.2.2012.

3.6. BEKIMI FETAR NË SHKOLLAT SHTETËRORE

Në gusht të vitit 1999, ministri i atëhershëm i Arsimit lëshoi një njoftim¹¹⁰ për të gjithë drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme që të ftojë njerëz fetarë për të bekuar fillimin e vitit të ardhshëm shkollor. Ky njoftim, së bashku me vendimin, ishte objekt vlerësimi i kushtetutshmërisë para Gjykatës Kushtetuese.

Megjithëkëtë, institucionet arsimore në varësi të strukturës religjioze të nxënësve kanë vepruar sipas njoftimit të marrë dhe kanë bërë zbatuar bekimin e vitit shkollor duke angazhuar persona fetarë të caktuar nga KOM-i dhe BFI-ja, përkatësisht, nga dy organizatat më të mëdha fetare, dhe jo nga të gjitha subjektet e regjistruara fetare.

Në atë kohë, neni 19 i Kushtetutës kishte parashikuar vetëm KOM-in si organizatë fetare, kështu që mbetet e paqartë se cilat ishin motivet që përveç përfaqësuesve të KOM-it, ministri të vendos t'i ftojë edhe përfaqësuesit e BFI-së, e jo edhe përfaqësuesit e organizatave tjera të regjistruara fetare.

Pas kërkesës së një organizatë joqeveritare, Gjykata Kushtetuese vlerësoi vendimin e Ministrisë të Arsimit në pajtueshmërinë me Kushtetutën¹¹¹. Organizata jo-qeveritare e kishte kontestuar aktin e ministrit të Arsimit si antikushtetues të paktën për 3 arsye:

1. nxënësit në shkollat fillore dhe të mesme i ekspozohen ndjekjes e aktiviteteve fetare pa miratimin e prindërve të tyre;
2. shkelet liria e besimit dhe fesë së personave që u përkasin besimeve të tjera, ose ateistëve, mbi bazën se bekimi u krye vetëm nga kleri i KOM-it dhe BFI-së, si dhe
3. akti bie ndesh me parimin kushtetues të ndarjes së shtetit nga religjioni.

Në Prill vitit 2000, Gjykata Kushtetuese miratoi vendimin¹¹² për anulimin e dekretit të ministrit, ku vendosi rregulla shtesë në lidhje me garantimin e shekullarizmit të shtetit. Gjykatësit iu referuan nenit 19 të Kushtetutës, i cili thotë se bashkësitë fetare janë të ndara nga shteti. Në bazë të analizës së dekretit të ministrit, Gjykata konkludoi se me të:

1. u prezantua aktiviteti fetar në shkollat fillore dhe të mesme dhe
2. kjo u bë me urdhër të organit shtetëror.

110 *Ministria e Arsimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut*, Njoftimi, nr.: 10-3445 / 1, Shkup, 24.8.1999.

111 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Aktvendimi nr. 195 / 1999-1-0, Shkup, 1.3.2000.

112 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Aktvendimi nr. 195 / 1999-0-0, Shkup, 19.4.2000.

Gjykata Kushtetuese nxori pesë konkluzione në lidhje me çështjen e ndarjes së bashkësive fetare nga shteti. Bazuar në parimin e ndarjes, shtetit nuk i lejohet të:

1. të përzihet në çështjet e fesë;
2. ta nxis përcaktimin për ndonjë fe ose fenë në përgjithësi;
3. të pengoj shprehjen e besimit;
4. ta imponojë konformizmin fetar, aktivitetet fetare ose ritet fetare si sjellje e dëshirueshme shoqërore dhe në përputhje me këtë
5. nuk mund të kërkojë ose të urdhërojë veprimtari fetare kudo dhe në çfarëdo forme.

Me vendimin e saj, **Gjykata Kushtetuese konfirmoi se shteti është neutral në lidhje me fenë dhe se nuk ka të drejtë të organizojë veprimtari fetare në shkollat publike, dhe as diku tjetër.**

Megjithëse praktika e bekimit në fillim të vitit shkollor në shkollat publike ishte e ndaluar, vërehen disa forma të tjera të bekimeve fetare, të cilat, megjithatë ndodhin, veçanërisht gjatë manifestimeve që lidhen me ndërtimin e objekteve nga shteti ose nga autoritetet lokale, kur personat fetarë kryejnë një formë të caktuar të bekimit fetar.

Prandaj, mbetet e paqartë nëse procedura të tilla paraqesin shkelje të vendimit të Gjykatës Kushtetuese apo nuk i përkasin kategorisë së bekimeve fetare.

3.7. VENDI I INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT TË LARTË TË ORGANIZATAVE FETARE

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, vetëm KOM-i dhe BFI kanë institucione të arsimit të lartë. Në lidhje me çështjen e statusit të tyre juridik, dallojmë dy faza:

1. deri në vitin 2008: statusi i institucioneve të arsimit të lartë të organizatave fetare nuk ishte i njëjtë me statusin e institucioneve të tjera publike të arsimit të lartë,
2. që nga viti 2008: institucionet e arsimit të lartë të organizatave fetare dhe institucionet e tjera publike të arsimit të lartë kanë status të barabartë.

Faza e dytë është e ndarë nga e para me Ligjin për Institucionet e Arsimit të Lartë të Komuniteteve Fetare¹¹³, të miratuar në vitin 2008.

113 *Ligji për institucionet e arsimit të lartë të bashkësive fetare*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti LXIV, nr.: 81, Shkup, 7.7.2008, f.: 6-8.

Gjatë fazës së parë, shteti nuk i njohu diplomat e lëshuara nga institucionet e arsimit të lartë të organizatave fetare dhe studentët e tyre nuk i kishin të njëjtat të drejta dhe detyra si kolegët e tyre në universitetet e njohura, as të diplomuarit ose magjistrat dhe doktorët e shkencës.

Me pak fjalë, shteti e kishte interpretuar parimin e ndarjes midis organizatave shtetërore dhe fetare në mënyrë shumë rigoroze, duke mos njohur asnjë të drejtë, detyrë ose status të institucioneve të arsimit të lartë që do të shkonin përtej organizatave fetare që i kishin krijuar ato.

Miratimi i Ligjit për Institucionet e Arsimit të Lartë të Komuniteteve Fetare shënon fillimin e fazës së dytë. Sipas nenit 1, institucionet e arsimit të lartë të bashkësive fetare, përkatësisht Fakulteti i Teologjisë i “Shën Klimenti i Ohrit” dhe Fakulteti i Shkencave Islame, kanë statusin e institucioneve jofitimprurëse publike-private të arsimit të lartë, në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë¹¹⁴, i cili u siguroi atyre statusin e kërkuar juridik.

Klauzola kryesore e Nenit 1 është koncepti institucion privat publik-privat jofitimprurës i arsimit të lartë, i cili, në nenin 2, pika 26, të Ligjit për Arsimin e Lartë përcaktohet si institucion i arsimit të lartë i themeluar nga një fondacion jofitimprurës me anë të fondeve publike me origjinë të brendshme ose të huaj, i cili gjeneron të mira thelbësore publike dhe është në interes të publikut. Çdo fond i fituar nga këto institucione mund të drejtohet vetëm në arsimin e lartë, sepse ato nuk krijojnë dhe nuk ndajnë fitim.

Dispozita e mësipërme lejon konkludimin se organizatat fetare u caktuan kështu në grupin e fondacioneve jofitimprurëse që veprojnë në interes të publikut, e cila është baza për të drejtën e tyre për të themeluar institucione të arsimit të lartë.

Prandaj, sipas nenit 26 të Ligjit për Arsimin e Lartë, fondacionet jofitimprurëse (si dhe persona të tjerë fizikë dhe juridikë vendas dhe të huaj) kanë të drejtë të krijojnë institucione joprofitabile publike-private të arsimit të lartë me miratimin e Qeverisë së RMV-së.

Ligji për Institucionet e Arsimit të Lartë të Bashkësive Fetare gjithashtu thotë se Fakulteti i Teologjisë “Shën Klimenti i Ohrit” dhe Fakulteti i Shkencave Islame kanë të drejtë të ofrojnë arsim të lartë në formën e studimeve universitare, pasuniversitare

114 *Ligji për arsimin e lartë*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LXIV, nr.: 35, Shkup, 14.3.2008, f.: 1-67.

dhe të doktoratës, si dhe të merren me veprimtari shkencore dhe kërkimore në sferën e shkencave teologjike ortodokse dhe islame, në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë (neni 2). Ata gjithashtu kanë të drejtë të jenë pjesë e universiteteve shtetërore si anëtarë të asociuar, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë (neni 4). Koncepti anëtar shoqëruar, sipas Nenit 2, pika 19, të Ligjit për Arsimin e Lartë, u referohet institucioneve, veprimtaria kryesore e të cilave është e lidhur në mënyrë funksionale me arsimin e lartë.

Më në fund, neni 7 i Ligjit mbi Institucionet e Arsimit të Lartë të Komuniteteve Fetare përcakton që Fakulteti i Teologjisë “Shën Klementi i Ohrit” dhe Fakulteti i Shkencave Islame të financohen, d.m.th., nga Buxheti i Shtetit. Sipas nenit 8, studentët e këtyre dy fakulteteve gëzojnë të njëjtat të drejta dhe detyra si studentët e universiteteve publike.

Pas miratimit të Ligjit për Institucionet e Arsimit të Lartë të Komuniteteve Fetare, statutet e Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi” dhe Universitetit Shtetëror në Tetovë u ndryshuan, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Arsimin e Lartë, kështu që Fakulteti i Teologjisë “Shën Klimenti i Ohrit” u bë pjesë e Universitetit “Shën Kirili dhe Metodi”, ndërsa Fakulteti i Shkencave Islame u bë pjesë e Universitetit Shtetëror në Tetovë. Kështu, të dy institucionet e arsimit të lartë përfunduan procesin e fitimit të statusit të personit juridik.

Kështu, ky proces nuk kaloi pa u vërejtur dhe reagimet që provokoi arritën kulmin me një iniciativë të cilën një grup profesorësh e dërguan në Gjykatën Kushtetuese, për të vlerësuar kushtetutshmërinë e dispozitave të Statutit të “Shën Kirili dhe Metodi” në lidhje me përfshirjen e Fakultetin Teologjik Ortodoks “Shën Klimenti i Ohrit” në përbërjen e Universitetit¹¹⁵.

Sipas profesorëve që ndërmorën iniciativën, procedura ishte në kundërshtim me Kushtetutën për dy arsye:

1. kjo çoi në ndërhyrjen e një subjekti fetar privat në vendimet e Senatit të Universitetit “Shën Kirilit dhe Metodi”, që është universitet shtetëror laik, dhe
2. privilegji i një institucioni fetar ndaj subjekteve të tjera fetare, në veçanti sepse tani është i financuar nga shteti, i cili përbën diskriminim ndaj subjekteve të tjera fetare në kundërshtim me nenin 19 të Kushtetutës¹¹⁶, i cili thotë se të gjitha subjektet fetare janë të barabarta para ligjit.

115 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë, *Aktvendimi u.nr. 172/2009-0-0*, Shkup, 23.12.2009.

116 *Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: XLVII, nr.: 52, op.cit.

Në lidhje me pjesën e parë të iniciativës, Gjykata Kushtetuese mori qëndrimin se përcaktimi i kompetencave të anëtarëve të lidhur për çështje të rëndësishme në lidhje me aktivitetet dhe vendimmarrjen e Senatit me Statutin e Universitetit nuk cenon autonominë e universitetit siç përcaktohet në Ligjin për Arsimin e Lartë. Prandaj, Gjykata konstatoi se ishte në përputhje me nenin 46 të Kushtetutës, i cili garanton autonominë e universiteteve.

Lidhur me pjesën e dytë të iniciativës që ka të bëjë me financimin e Fakultetit Teologjik Ortodoks, gjykatësit kushtetues kanë konstatuar se Ligji për Institucionet e Arsimit të Lartë të Bashkësive Fetare përcakton që mjetet për financimin e veprimtarisë së Fakultetit Teologjik Ortodoks, sigurohen, përveç nga mjetet e themeluesve, edhe nga buxheti i RMV-së, që do të thotë se ligjvënësi ka përcaktuar që puna e këtij fakulteti do të financohet edhe nga buxheti i RMV-së, pavarësisht nëse ka fituar statusin e anëtarit të shoqërues të Universitetit apo jo.

Me këtë, Gjykata Kushtetuese nuk e pranoi iniciativën, dmth. vendosi të mos fillojë procedurën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së neneve të Statutit të Universitetit “Shën Kirilit dhe Metodi”.

Pasi kundërshtarët e kishin shteruar këtë mundësi ligjore, institucionet e arsimit të lartë të bashkësive fetare fituan subjektivitetin e nevojshëm juridik, duke zhvendosur kështu lavjerrësin e shekullarizmit në favor të organizatave fetare.

3.8. KREMTIMI SHTETËROR I FESTAVE FETARE

Kremtimi i festave fetare është çështje thelbësore për analizën e sistemit të marrëdhënieve midis shtetit dhe organizatave fetare dhe ushtrimit të lirisë së fesë. Në Republikën e pavarur të Maqedonisë së Veriut, kjo çështje për herë të parë është rregulluar me Ligjin për Festat, i miratuar në vitin 1998¹¹⁷, sipas të cilit pushimet u ndanë në dy kategori:

1. “festat shtetërore (neni 2) dhe
2. “ditët e pushimit që janë ditë jo pune” (neni 4).

Kategoria e festave shtetërore nuk përfshinte ndonjë festë të karakterit fetar, ndërsa kategoria e dytë përfshinë, për herë të parë, pesë festa fetare:

- » Dita e Krishtlindjeve dhe e hëna e Pashkëve për të krishterët,
- » Dita e parë e Bajramit të Ramazanit dhe dita e parë e Bajramit të Kurbanit për pjesëtarët e besimit Islam, si dhe

117 *Ligji për festat në Republikën e Maqedonisë*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LIV, nr.: 21, Shkup, 8.5.1998, f.: 1214.

- » Yom Kippur-i për pjesëtarët e komunitetit hebre.

Me Ligjin për Festat, që nga viti 1998, Republika e Maqedonisë së Veriut u bë pjesë e atyre shteteve që festojnë festat më të rëndësishme të dy grupeve më të mëdha fetare, Krishterimin Ortodoks dhe Islamin, dhe gjithashtu Judaizmin.

Duke marrë parasysh numrin e anëtarëve të grupeve fetare si kriter kryesor, ligjvënësi nuk arriti të rregullonte kremtimin e festave të grupeve të tjera fetare me një numër relativisht të lartë të anëtarëve, të tillë si katolikët, numri i të cilëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut tejkalon numri i hebrenjve. Përveç kësaj mangësie, Ligji ishte i pari që prezantoi kremtimin e festave fetare pas pavarësisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe zëvendësimin e rendit socialist.

Me ndryshimet në Ligjin për Pushimet në vitin 2007¹¹⁸, u arrit një balancë midis shtetit dhe feve. Në këtë akt, ligjvënësi i ka ndarë festat në tri kategori:

1. *"festat shtetërore* (neni 1 paragrafi 1);
2. *"festat"* (neni 1 paragrafi 2);
3. *"ditët që kremtohen dhe që janë ditë jo pune"* (neni 2).

Në grupin e festave shtetërore të RMV-së janë përfshirë dy festat fetare që kanë të bëjnë me variantin ortodoks të krishterimit si konfesion fetar dominues, dmth. 24 maj - dita e iluministëve sllavë *"Shën Kirili dhe Metod"* dhe 8 Dhjetori - *"Shën Klimenti i Ohrit"*.

Kategoria e dytë e festave të Republikës së Maqedonisë së Veriut përfshinte festat fetare: Krishtlindjet (festohen me 7 janar, sipas kalendarit Julian), e hëna e Pashkëve (Pashkët Ortodokse, sipas kalendarit Julian), si dhe Bajrami i Ramazanit (dita e parë e Bajramit të Ramazanit).

Një numër shtesë i festave fetare janë përfshirë në kategorinë e tretë, festat që janë ditë jo pune, të ndara në dy grupe:

1. Vigjilja (Buzmi) e Krishtlindjes, Epifania (Ujët e bekuar, festohet më 19 Janar), e Premtja e Madhe (e Premte para Pashkëve), Fjetja e Nënës së Zotit (28 Gusht) dhe Rrëshaja (e Premte para Rrëshajave) për të Krishterët Ortodoks.
2. Bajrami i Kurbanit (dita e parë e Bajrami i Kurbanit) për myslimanët; Jom Kippur për hebrenjtë; Vigjilja e Krishtlindjeve, e hëna e Pashkëve dhe dita e të gjithë shenjtorëve sipas Kalendarit Gregorian për Katolikët; dhe Dita e Shën Savës (27 Janar) për komunitetin serb.

118 *Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për festat në Republikën e Maqedonisë*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LXIII, nr.: 18, Shkup, 2/15/2007, f.: 4-5.

Me ndryshimet në Ligjin për festat në vitin 2007, shteti kremton 27 festa të ndara në tri kategori të përmendura, 15 prej të cilave janë të natyrës fetare. Në grupin e parë të “festave publike të RMV-së” kremtohen dy festa fetare (24 maj - “Shën Kirili dhe Metodi” dhe 8 Dhjetori - “Shën Klimenti i Ohrit”), të cilat kanë të bëjnë me vlerat e Krishterimit Ortodoks si fe më e madhe.

Prandaj, Republika e Maqedonisë së Veriut, në kuptimin simbolik të fjalës, e përcaktoi veten si shtet që e konsideron Krishterimin Ortodoks një nga shtyllat e shtetësisë së saj, madje edhe më shumë që të dy festat shtetërore me origjinë Ortodokse u shpallën si ditë jo pune për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga feja e tyre.

Kategoria e dytë e festave të Republikës së Maqedonisë së Veriut përfshin tri festa fetare, dy prej të cilave kanë të bëjnë me Krishterimin Ortodoks (Dita e Krishtlindjeve dhe e hëna e Pashkëve) dhe një me Islamin (Dita e Parë e Bajramit të Ramazanit).

Edhe kjo kategori pushimesh, simbolikisht pasqyron strukturën e Republikës së Maqedonisë së Veriut me një popullsi kryesisht ortodokse të krishterë, por gjithashtu merr parasysh Islamin si fe të grupit të dytë më të madh të popullsisë. Një argument në favor të këtij grupi është se festat deklarohen si ditë jo pune për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga feja e tyre.

Kategoria e tretë, festat që janë ditë jo pune, përfshinë 11 festa fetare, 6 prej të cilave janë të krishtera ortodokse (Vigjilja e Krishtlindjeve, Epifania, E Premtja e Madhe, fjetja e Nënës së Zotit, Rrëshaja, si dhe Dita e Shën Savës për komunitetin ortodoks serb, 3 janë katolikë (Vigjilja e Krishtlindjeve, Pashkët dhe Dita e Gjithë Shenjtorëve), një është festë islame (Bajrami i Kurbanit) dhe një është hebreje (Jom Kippur). Ndryshe nga festat e dy kategorive të para, këto ditë kremtohen dhe janë ditë pushimi vetëm për bashkësinë fetare/etnike të cilës i referohen.

Me Ligjin për Festat dhe ndryshimet në të në vitin 2007, **Republika e Maqedonisë së Veriut deklaroi se konteksti fetar është një nga burimet nga i cili ajo merr legjitimitetin e saj si shtet, para së gjithash nga vlerat e krishtera ortodokse, por edhe nga vlerat e fetë e tjera, dhe mbi të gjitha nga vlerat e Islamit.** Duke pasur parasysh vlerat e feve të pakicave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Ligji u lejon anëtarëve të atyre bashkësive fetare të kremtojnë festat e tyre të rëndësishme.

Ky ligj, gjithashtu, ka qenë objekt i reagimeve të ndryshme që kulmojnë me paraqitjen e iniciativave përkatëse për vlerësim të kushtetutshmërisë në Gjykatën Kushtetuese¹¹⁹.

119 Në periudhën nga viti 1998 deri më 2010, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut është deklaruar për tri iniciativa: *Aktvendimi* nr.: 122/1998-0-0 од 7.10.1998, *Aktvendimi* nr.: 138/2009-0-0 од 24.6.2009 dhe *Aktvendimi* nr.: 12/2010-0-0 од 3.9.2011.

Objekt kontesti me iniciativën konkrete ishte fakti që RMV siguron kremtimin e festave të ndryshme për pjesëtarët e përkatësive të ndryshme fetare. Kështu, në vitin 1998, një grup qytetarësh paraqiti paraqitën iniciativën e parë për fillimin e procedurës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit¹²⁰, sepse me të parashikohej ndarja e qytetarëve në baza fetare dhe bëhej përzgjedhja dhe trajtimi i ndryshëm i qytetarëve përmes caktimit të ditëve të ndryshme të kremtimit të festave fetare. Sipas parashtruesve të iniciativës, ky fakt shkaktoi pabarazi në mesin e qytetarëve, sepse, sipas aplikimit të tyre, dispozita e diskutueshme ligjore ishte në kundërshtim me nenin 9 të Kushtetutës.

Sipas një iniciative tjetër, neni 4 i ligjit nuk ishte në përputhje me nenin 19, paragrafi 3, të Kushtetutës, sepse përcaktimi i festave për tre nga bashkësitë fetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut, por jo edhe për të tjerat, nënkuptonte trajtim të pabarabartë të komuniteteve fetare, duke bërë që të mos ishin të barabartë para ligjit.

Në aktvendimin e sjellë¹²¹, gjykatësit kushtetues kanë konstatuar se pjesëtarët e organizatave të ndryshme fetare kanë vlera të ndryshme në të cilat besojnë ose besonin në të njëjtat vlera, por me përparësi të ndryshme. Një diversitet i tillë përmbajtësor nxiti manifestime të ndryshme të besimit, përkatësisht ditë të ndryshme të kremtimit të vlerave fetare, ditë të ndryshme të jenë ditë pushimi dhe të festohen nga komunitete të ndryshme fetare, që, sipas Gjykatës, pikërisht kjo siguron barazinë e qytetarëve mbi baza fetare.

Lidhur me pretendimet se neni 4 parashikonte pabarazi midis ortodoksisë, islamit dhe judaizmit, nga njëra anë dhe bashkësive të tjera fetare, nga ana tjetër, Gjykata Kushtetuese vlerësoi se iniciativa nuk e vinte në pikëpyetje që të tre grupet fetare të kremtojnë festat e tyre, por kërkonte të drejtën edhe për grupet e tjera fetare për të festuar festat e tyre. Kjo do të kishte për qëllim që Gjykata të plotësonte dispozitën e diskutueshme ligjore, e cila nuk është në kompetencën e Gjykatës Kushtetuese.

Përveç iniciativës së lartpërmendur, më 2009¹²² dhe 2010¹²³, dy iniciativa të tjera u paraqitën në Gjykatën Kushtetuese, të cilat, gjithashtu u refuzuan me arsyetimin se gjykatësit kushtetues në vitin 1998 kishin vendosur tashmë mbi këtë çështje.

120 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut, *Aktvendimi* u.nr.: 122/1998-0-0, op.cit.

121 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut, *Aktvendimi*.nr.: 122/1998-0-0, op.cit.

122 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut, *Aktvendimi* nr.: 138/2009-0-0, op.cit.

123 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut, *Aktvendimi* nr.: 12/2010-0-0, op.cit.

3.9. STATUSI I AKTEVE TË ORGANIZATAVE FETARE

Statusi i akteve të organizatave fetare brenda sistemit juridik të Republikës së Maqedonisë së Veriut bazohet në aktvendimet e Gjykatës Kushtetuese përkatësisht të vitit 1996¹²⁴, dhe 2000¹²⁵.

Aktvendimet rezultojnë nga dy iniciativat e paraqitura në Gjykatë në të cilat parashtruesit kërkojnë që disa pjesë të Kushtetutës së KOM-it të shpallen si jokushtetuese, si dhe dispozita të tjera të kësaj organizate fetare, të cilat, në mënyrë analoge, supozohet se e njëjta kërkesë ka të bëjë edhe me aktet e organizatave të tjera fetare në RMV.

Në kërkesën e parë, të paraqitur në vitin 1996, një person kërkonte të mbrojtë liritë dhe të drejtat e grave, të cilat konsideronte se ishin të diskriminuara gjatë kurorëzimit kishtar, sepse në aktin solemn të kurorëzimit në kishë krijojnë traumë psikologjike për gjininë femërore pasi kleriku në këtë mënyrë ka predikuar se gruaja ishte e barabartë me burrin, por ajo gjithmonë duhej t'i bindej burrit.

Sipas parashtruesve të kërkesës, fjalët e tilla të klerikut ishin në kundërshtim me normat pozitive juridike në vend, sepse privonin të drejtat e garantuara kushtetuese të gruas. Parashtruesi, gjithashtu, pretendonte se Kisha Ortodokse Maqedonase ka krijuar pabarazi midis burrave dhe grave, bazuar në faktin që lejonte burrat të hynin në kisha pa kokëjashtë, ndërsa gratë mund të hynin vetëm me flokët e mbuluara, të pa grim dhe të veshura në mënyrë të përshtatshme.

Kërkesa e dytë u paraqit në Gjykatën Kushtetuese në vitin 1999 nga një qytetar, në emër të një grupi prindërisht të murgjve dhe murgeshave. Ankuesit pretenduan se atyre u ishte mohuar e drejta për t'u kujdesur nga fëmijët e tyre në rast sëmundjeje, kur janë të pamundur ose në moshën e pleqërisë, bazuar në rregullin kanonik që ndalon çdo kontakt të murgjve dhe murgeshave me prindërit e tyre, i cili zbatohet brenda KOM-it.

Përveç kësaj, ankuesit pretendonin se KOM-i nuk ka të drejtë të themelojë njësi të tjera, siç janë manastiret, pasi e vetmja formë e njësisë shoqërore e njohur në Kushtetutë është familja, e cila gëzon mbrojtjen e duhur. Sipas parashtruesve, duke e deklaruar veten pronare të njësisë shoqërore, KOM-i gjithashtu e deklaroi veten pronare të qenieve njerëzore dhe kështu privon murgjit dhe murgeshat,

124 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut, *Aktvendimi nr.: 32/1996-0-0, Shkup, 14.2.1996.*

125 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut, *Aktvendimi nr. 1176 / 1999-0-0, Shkup, 17.5.2000.*

d.m.th fëmijët, nga e drejta e lirisë, mendimit dhe shprehjes së saj publike, liria e fjalës, paraqitja publike dhe informimi publik, e drejta për liri dhe privatësi të korrespondencës, e drejta për të ushtruar një mandat publik, e drejta për të paraqitur kërkesa në organet shtetërore, e drejta për lëvizjen e lirë në territorin e RMV-së, e drejta për të marrë pjesë në mbrojtjen e shtetit, e drejta e pronës dhe trashëgimisë, e drejta për leje me pagesë, sigurime shoqërore, mbrojtje shëndetësore, si dhe të drejta të tjera. Duke marrë parasysh që fëmijët e tyre që janë murgjit dhe murgeshat të mbahen si skllëvër, Iniciuesit, gjithashtu thirrën në Konventën e Skllavërisë, e cila thotë se që një person të konsiderohet skllav, është e parëndësishme nëse ata janë pajtuar vullnetarisht të jetojnë në kushte të tilla janë të mitur ose të rritur.

Lidhur me këto dy iniciativave, Gjykata Kushtetuese, duke iu referuar nenit 19 të Kushtetutës, si dhe Ligjit për Shoqatat e Qytetarëve dhe Fondacionet¹²⁶, i hedh poshtë ato si të pabaza, duke konkluduar:

1. Kisha, si dhe parimet dhe normat që vijnë nga shkrimet e shenjta fetare, janë të ndara nga shteti dhe rendi i saj juridik, d.m.th., nuk është në kompetencën e shtetit për të vlerësuar ato shkrime në lidhje me Kushtetutën, as për të vendosur nëse, bazuar në to, një besimtar diskriminohet, duke pasur parasysh dispozitën kushtetuese për lirinë e fesë.
2. Gjykata Kushtetuese vlerësoi se nuk është në kompetencën e saj të vendosë për kërkesat e ankuesve, pasi ata nuk kërkojnë mbrojtjen e të drejtave të lirive të shkelura nga një akt juridik i miratuar ose një veprim i kryer nga një organ shtetëror, as mbrojtje ndaj diskriminimit bazuar në përkatësinë fetare të kryer nga një organ shtetëror.
3. Kisha Ortodokse Maqedonase (si dhe të gjitha organizatat e tjera fetare) ka organizatën e vet, e cila rregullon dhe menaxhon në mënyrë të pavarur aktivitetet e saj.
4. Liria e fesë do të thotë që besimtarët janë të lirë të zgjedhin se si dëshirojnë ta ushtrorjnë fenë e tyre, e cila është një çështje rreptësisht personale, d.m.th. pjesë e privatësisë së një personi. Kjo do të thotë që çdo qytetar ka të drejtë t'i përkasë çdo komuniteti fetar dhe të ndjekë mësimet e tij, ose të mos i përkasë asnjë bashkësi fetare.
5. Dispozita që feja është çështje personale përcakton gjithashtu lidhjen e organizimit fetar me shtetin. Por, sipas Kushtetutës, KOM-i, si të gjitha organizatat e tjera fetare, është e ndarë nga shteti. Në të njëjtën kohë, organizatat fetare janë të barabarta dhe ndajnë një të drejtë të barabartë

126 *Ligji për shoqatat e qytetarëve dhe fondacionet*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LIV, nr.: 31, Shkup, 2.7.1998, f.: 1724-1731.

për të kryer aktivitetet dhe ritualet e tyre, dhe ato i nënshtrohen trajtimit të barabartë nga shteti në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin, që do të thotë se nuk mund të ketë një fe shtetërore të cilat do të privilegjoreshin dhe kontrolloheshin nga shteti.

6. Kisha Ortodokse Maqedonase nuk është as shoqatë qytetare dhe as ndonjë lloj shoqate e institucionalizuar e besimtarëve, d.m.th. KOM-i dhe organizatat e tjera fetare përfaqësojnë forma të shprehjes së besimit, vetëm ose me të tjerët, dhe kështu nuk janë të organizuara në përputhje me Ligjin për Shoqatat dhe Fondacionet e Qytetarëve.
7. Meqenëse KOM-i nuk është shoqatë qytetare, por më tepër një formë e caktuar e kongregacionit të qytetarëve për të shprehur besimin e tyre, Gjykata Kushtetuese vlerëson se kushtetuta e KOM-it nuk mund t'i nënshtrohet vlerësimit të saj.

3.10. PËRKRAHJA E SHTETIT NË LUFTËN PËR AUTOQEFALI TË KISHËS ORTODOKSE MAQEDONASE

Që nga pavarësia e shtetit, institucionet e RMV-së vazhdimisht kanë miratuar një qëndrim **paternalist ndaj Kishës Ortodokse Maqedonase, veçanërisht në lidhje me përpjekjet e saj për njohjen nga Kishat e tjera Ortodokse në të gjithë botën dhe në këtë mënyrë përmbushin legjitimitetin dhe ligjshmërinë.**

Nga pikëpamja zyrtare, kjo politikë arriti kulmin në vitin 2004 kur Kuvendi miratoi *Deklaratën për Mbështetjen e Autoqefales së KOM-it*¹²⁷.

Kjo deklaratë u miratua në një kohë kur një peshkop dhe disa klerikë u larguan nga Kisha Ortodokse Maqedonase dhe kishin themeluar organizatën e tyre fetare, e cila më pas u njoh nga kishat ortodokse në të gjithë botën.

Kështu, në RM, paralelisht me KOM-in filloi të ekzistojë edhe një organizatë tjetër fetare që kërkon të tërheqë besimtarët të krishterë ortodoksë në RM. Por, dallimi është se **KOM-i ka legjitimitet në RMV, sepse është subjekt juridik legal, të cilin organizata e re fetare nuk e ka, sepse ajo nuk është regjistruar. Nga ana tjetër, Kisha Ortodokse Maqedonase nuk posedon legjitimitet midis Kishave Ortodokse mbarëbotërore sepse nuk njihet, gjë që, në të kundërt, është rasti me organizatën tjetër fetare.**

127 *Deklarata për Mbështetjen e Autoqefales së Kishës Ortodokse Maqedonase*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LX, nr. 4, Shkup, 2.2.2004, f.: 3.

Miratimi i Deklaratës drejtoi vëmendjen në nenin 9, paragrafi 2, të Kushtetutës, i cili thotë se KOM-i, si dhe të gjitha bashkësitë tjera fetare dhe grupet religjioze, janë të ndarë nga shteti. Por, në përputhje me nenin 69, paragrafin 2 të Kushtetutës¹²⁸, Kuvendi ka të drejtë të miratojë vendime, deklarata, rezoluta, rekomandime dhe konkluzione brenda kompetencave të tij.

Autorët e propozimit për të miratuar Deklaratën ndoqën logjikën e nenit 19 në tërësinë e tij, i cili përcakton **Kishën Ortodokse Maqedonase si kategori kushtetuese, pasi ajo përmendet shprehimisht në Kushtetutë, prandaj ata thirren në të drejtën për të miratuar akte juridike që kanë të bëjë me KOM-in.**

Me miratimin e Deklaratës, Kuvendi shprehu mbështetjen dhe respektin ndaj vendimit për shpalljen e autoqefales së KOM-it më 18.7.1967. Përveç kësaj, Kuvendi mbështeti KOM-in në tri çështje:

1. ruajtjen e unitetit të brendshëm;
2. njohjen e emrit të saj – KOM, si dhe
3. njohjen e statusit të saj autoqefal.

Në mbledhjen e mbajtur në vitin 2004, organi më i lartë i Kishës Ortodokse Maqedonase, Sinodi i Shenjtë i Kishës Ortodokse Autoqefale, miratoi një rezolutë në të cilën, ndër të tjera, i shprehu mirënjohje Kuvendit për miratimin e Deklaratës¹²⁹.

Kjo Deklaratë çoi në krijimin e të paktën katër rrethanave të reja:

1. **Shteti siguron legjitimitet juridik për një akt të brendshëm të një organizate fetare**, përkatësisht për shpalljen e autoqefalisë, e cila, sipas dispozitave ligjore, nuk ka efekt juridik jashtë Kishës Ortodokse Maqedonase.
2. **Lidhur me aktivitetet e organizatave fetare**, shteti sfidon parimin e ndarjes duke dhënë mbështetje dhe duke shprehur gatishmëri për të ndihmuar në lidhje me aktivitetet ndërkombëtare të Kishës Ortodokse Maqedonase për njohjen e legjitimitetit të saj nga Kishat e tjera Ortodokse.
3. Parimi i ndarjes prishet në sfondin e zhvillimeve të brendshme të KOM-it pas themelimit të një organizate fetare të panjohur (e cila po garon me kishën ortodokse maqedonase për të tërheqë besimtarë të krishterë ortodoks), me shtetin që mbështet unitetin e brendshëm të KOM-it, pra për të penguar ndarjen e besimtarëve.


128 Ibid.

129 *Rezoluta e Sinodit të Shenjtë të Kishës Ortodokse Maqedonase*, 12.11.2004, (mpc.org.mk), 10.3.2018.

4. Në lidhje me të drejtat e njeriut, shteti demonstroi se e vetmja organizatë fetare që operon në interes të të krishterëve ortodoksë në Republikën e Maqedonisë është KOM-i, sepse është një subjekt juridik-legal, i cili mund t'i përmbushë nevojat fetare vetëm brenda kornizave të veta.

Në lidhje me modelin maqedonas të marrëdhënieve midis shtetit dhe organizatave fetare, Deklarata zbulon trashëgiminë e Perandorisë Bizantine (në kundërshtim me standardet ndërkombëtare të Europës Perëndimore dhe faktin se Republika e Maqedonisë së Veriut nuk është shtet homogjen në aspektin fetar), i cili bazohet në një sistem uniteti midis pushtetit laik dhe fetar, ose në këtë rast, si të thuash, RMV dhe KOM-i.

Kështu, siç kemi parë nga rastet e tjera të përshkruara në këtë kapitull, shihet se në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk ka unanimitet në lidhje me balancën e faktorëve që përcaktojnë modelin e marrëdhënieve midis shtetit dhe organizatave fetare dhe lirinë e fesë.



4

KORNIZA INSTITUCIONALE

4. KORNIZA INSTITUCIONALE

Modeli i shekullarizmit në RMV, si në çdo shtet tjetër demokratik, përbëhet nga një rrjet të institucioneve, të cilat, sipas kompetencave të tyre, kanë mekanizmat e tyre juridikë për zbatimin e tij të përgjithshëm. Institucionet shtetërore që kanë të bëjnë me marrëdhëniet midis shtetit dhe organizatave fetare mund të ndahen në tre grupe:

1. **Grupi i parë** përfshinë organet, puna e të cilave përqendrohet kryesisht në marrëdhëniet midis shtetit dhe organizatave fetare: Komisioni për Marrëdhënie me Bashkësitë Fetare dhe Grupet Religjioze;
2. **Grupi i dytë** përfshin institucionet, të cilat, jo vetëm që merren me çështjen e marrëdhënieve midis shtetit dhe organizatave fetare, por gjithashtu, ndër të tjera, me të drejtat dhe liritë fetare: Gjykata Kushtetuese¹³⁰;
3. **Grupi i tretë** përfshinë organet, të cilat merren me çështjen e ushtrimit, ndër të tjera, të të drejtave dhe lirive fetare: Komisioni i Përhershëm Anketues për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave pranë Parlamentit, Avokati i Popullit dhe Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Më poshtë vijon një vështrim më konkret i aktiviteteve të tyre:

4.1. KOMISIONI PËR MARRËDHËNIE ME BASHKËSITË FETARE DHE GRUPET RELIGJIOZE

Komisionet për marrëdhënieve me bashkësitë fetare si element ndërmjetës midis shtetit dhe organizatave fetare kanë ekzistuar që nga koha e Republikës Socialiste të Maqedonisë¹³¹. Por, dallimi me komisionin e sotëm qëndron në qasjen ndaj çështjes së autonomisë së organizatave fetare, si dhe çështjes së lirisë së fesë.

Sot, kompetencat e Komisionit për Marrëdhënie me Bashkësitë Fetare dhe Grupet Religjioze janë të rregulluara:

130 Për rolin e gjykatave kushtetuese në demokratizimin e shteteve të mëparshme socialiste ose komuniste, shih: James T. Richardson Religion, *Constitutional Courts, and Democracy in Former Communist Countries*, The Annals of the American Academy, January 2006, f.: 129-137.

131 **Komisioni i parë për Marrëdhënie me Bashkësitë Fetare është themeluar më 1945 me Dekretin për krijimin e një Komisioni Shtetëror për Çështje Fetare** (Dekret për themelimin e një Komisioni Shtetëror për Çështje Fetare, Gazeta Zyrtare e Republikës Popullore Federative të Jugosllavisë, viti: I, nr.: 62, Beograd), 21.8.1945, f.: 589).

1. me Kushtetutë;
2. Ligjin për statusin juridik të kishës, bashkësisë fetare dhe grupit religjioz, dhe
3. me Ligjin për organet e administratës shtetërore.

Në nenin 19 të Kushtetutës thuhet se Kisha Ortodokse Maqedonase, si dhe BFI, Kisha Katolike, Kisha Ungjillore Metodiste, bashkësitë e tjera fetare dhe grupet religjioze janë të ndara nga shteti dhe janë të barabartë para ligjit.

Ligji për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore i referohet Kushtetutës në nenin 29 të tij, i cili përcakton formimin e një komisioni për marrëdhëniet me bashkësitë fetare dhe grupet të jetë në vend si organ i veçantë i administratës shtetërore me statusin e personit juridik.¹³²

Neni 29 përcakton gjithashtu dy fusha të përgjegjësive të Komisionit për Marrëdhëniet me bashkësitë fetare dhe grupet religjioze:

1. Statusin juridik të bashkësive fetare dhe grupeve religjioze; dhe
2. Marrëdhëniet midis shtetit, bashkësive fetare dhe grupeve religjioze.

Kompetencat shtesë përcaktohen në Ligjin për Statusin Juridik të Kishave, Bashkësive Fetare dhe Grupeve Religjioze, të miratuar në vitin 2007:

1. Sipas nenit 35, Komisioni i siguron Gjykatës Themelore II në Shkup të dhënat dhe dokumentacionin për të gjitha organizatat fetare të renditura në regjistër në përputhje me dispozitat e Ligjit për bashkësitë fetare dhe grupet religjioze të miratuar në vitin 1997¹³³;
2. Sipas nenit 7, paragrafi 2, institucionet shtetërore, brenda kompetencave dhe autorizimeve të tyre, krijojnë kushte në mënyrë që kishat, bashkësitë fetare dhe grupet religjioze të mund t'i kryejnë aktivitetet e tyre në mënyrë të papenguar. Meqenëse Komisioni është një organ ndërmjetës midis shtetit dhe organizatave fetare, të gjitha procedurat në lidhje me institucionet që konsiderohen të veprojnë në kundërshtim me dispozitat e mësipërme i drejtohen asaj.
3. Sipas nenit 9, paragrafi 2, Komisioni mban shënime për të gjitha organizatat e regjistruara fetare.
4. Sipas nenit 23, Komisioni është organi i cili, në përputhje me procedurën e caktuar, komunikon me organizatat fetare në lidhje me të gjitha çështjet që lidhen me themelimin e institucioneve arsimore fetare.

132 *Ligji për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LVI, nr.: 58, Shkup, 21.7.2000, f.: 3984-3991.

133 *Ligji për bashkësitë fetare dhe grupet religjioze*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. LIII, nr: 35, op.cit.

5. Sipas nenit 25, Komisioni, në përputhje me dispozitat për vendbanimin e shtetasve të huaj, u jep të drejtë organizatave fetare të punësojnë shtetas të huaj për të dhënë mësim në institucionet e tyre arsimore, të organizuara prej tyre.

Përveç sa u tha më sipër, Komisioni, që nga miratimi i Ligjit për Statusin Juridik të Kishës, Bashkësisë Fetare dhe Grupit Religjioz më 2007 deri në vendimin e Gjykatës Kushtetuese më 2010¹³⁴, kur u shfuqizua neni 27¹³⁵, kishte kompetencë të konsultohet me organizatat fetare në emër të RMV-së në përgatitjen e për përgatitjen e plan-programeve mësimore në lëndën e mësim-besimit.

4.2. GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËLS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Që nga pavarësia e RMV-së, Gjykata Kushtetuese, me iniciativën e vet ose në bazë të kërkesave të paraqitura nga persona fizikë ose juridikë, disa herë ka vepruar dhe miratuar vendime të përkatëse në lidhje me mbrojtjen e lirive dhe të drejtave fetare të qytetarëve, si dhe për çështjen e marrëdhënieve të përcaktuara me kushtetutë midis shtetit dhe organizatave fetare.

Gjykata Kushtetuese ka luajtur rol të rëndësishëm në përcaktimin e kornizës dhe kufijve të modelit maqedonas të shekullarizmit.

Kapitulli IV i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut i referohet Gjykatës Kushtetuese¹³⁶, e cila përcaktohet si institucion shtetëror përgjegjës për mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së shtetit (neni 108). Lidhur me çështjet e shtjelluara në punim, Gjykata Kushtetuese ka për obligim:

1. t'i mbrojtë të drejtat dhe liritë e njeriut dhe qytetarit në lidhje me lirinë e bindjes, ndërgjegjes, mendimit dhe shprehjes publike të mendimit, shoqërimit dhe veprimtimit politik, si dhe ndalimin e diskriminimit midis qytetarëve për shkak të seksit, racës, fesë ose përkatësisë kombëtare, shoqërore ose politike (neni 110, paragrafi 3);
2. të vendos për:
 - » Pajtueshmërinë e ligjeve me Kushtetutën sipas nenit 110, alineja 1, dhe veçanërisht, duke pasur parasysh qëllimin e këtij manuali, harmonizimin e ligjeve me nenin 19, i cili garanton lirinë e fesë dhe thotë se organizatat fetare janë të ndara

134 Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë, *Vendimi u. nr. 104 / 2009-0-1*, op.cit.

135 *Ligji për statusin juridik të kishës, bashkësisë fetare dhe grupit religjioz*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LXIII, nr.: 113, op.cit.

136 *Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: XLVII, nr.: 52, op.cit.

nga shteti dhe se ata mund të themelojnë institucione fetare arsimore, shoqërore dhe bamirëse në përputhje me ligjin;

- » Përputhshmërinë e dispozitave tjera dhe marrëveshjeve kolektive me Kushtetutën dhe ligjet (neni 110, alineja 2), dhe
- » Përputhshmërinë e programeve dhe statuteve të partive politike dhe shoqatave të qytetarëve me Kushtetutën dhe ligjin (neni 110, alineja 7).

Në bazë të nenit 113 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese i ushtron kompetencat e saj sipas një akti të brendshëm, d.m.th. me Rregulloren e punës¹³⁷.

4.3. KOMISIONI I PËRHERSHËM ANKETUES PËR MBROJTJEN E LIRIVE DHE TË DREJTAVE TË QYTETARIT

Sipas nenit 61 të Kushtetutës¹³⁸, Kuvendi është organ përfaqësues i qytetarëve dhe organ legjislativ i shtetit. Sipas nenit 76, paragrafi 1, Kuvendi themelon organe pune të përhershme dhe të përkohshme, midis të cilave është edhe Komisioni i Përhershëm Anketues për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Civile.

Neni 76, paragrafi 2, përcakton që të ngrihet një komision i përhershëm anketues për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive civile, gjë që çon në konkludimin se Komisioni i Përhershëm Anketues ka një rëndësi dhe legjitimitet shumë më të madh se organet e tjera të punës së Kuvendit, themelimi i të cilave nuk është paraparë me Kushtetutë.

Ky fakt tregon se të drejtat dhe liritë e qytetarëve zënë një pozitë të rëndësishme në Kushtetutë, përfshirë të drejtat dhe liritë fetare, pasi të drejtat dhe liritë e njeriut përfaqësojnë një nga shtyllat themelore të shtetësisë së Maqedonisë së Veriut.

Komision të Përhershëm Anketues për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave, si edhe organet tjera punuese, punon në seanca dhe ushtron këto kompetenca¹³⁹:

1. Shqyrton çështjet parimore dhe, në përputhje me rrethanat, jep propozime dhe mendime mbi zbatimin e dispozitave të Kushtetutës, ligjeve, dispozitave dhe akteve të tjera të rëndësishme për ushtrimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive civile;

137 Shih: *Rregullorja e punës e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë, Shkup, (ustavensud.mk), 10.3.2018.

138 *Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: XLVII, nr.: 52, op.cit.

139 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, *Komisioni i Përhershëm Anketues për Liritë dhe të Drejtat e Qytetarit*, (sobranie.mk), 10.3.2018.

2. Vë në spikamë nevojën e miratimit të ligjeve, dispozitave dhe akteve të tjera, për mbrojtjen e plotë të të drejtave dhe lirive civile;
3. Ndjek, shqyrton dhe analizon zbatimin e akteve të ratifikuara ndërkombëtare që rregullojnë mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarit;
4. Shqyrton korrespondencat me qytetarët dhe, në përputhje me rrethanat, merr qëndrime lidhur me to;
5. Bashkëpunon me organizata shkencore dhe profesionale në fushën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të qytetarit;
6. Bashkëpunon me trupat përkatëse të huaja dhe ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të qytetarit, si dhe
7. Merrret me çështje të tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të qytetarit.

Në ushtrimin e kompetencave të tij, Komisioni të Përhershëm Anketues për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Civile nuk mund të kryejë hetime ose të kryejë funksione të tjera gjyqësore, megjithatë, gjetjet e tij mund të shërbejnë si bazë për fillimin e një procedure për përcaktimin e përgjegjësisë ndaj bartësve të funksioneve publike.

4.4. AVOKATI I POPULLIT

Sipas nenit 77 të Kushtetutës, Kuvendi zgjedh Avokatin e Popullit, detyra e të cilit është të mbrojë të drejtat kushtetuese dhe ligjore të qytetarëve në rast të shkeljes nga organet e administratës shtetërore ose organe dhe organizata të tjera me autorizime publike.

Me amendamentin XI të Kushtetutës i cili i referohet nenit 77 janë bërë dy ndryshime:

- » **Mënyra e zgjedhjes:** Avokati i Popullit zgjidhet me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të deputetëve, ndërsa duhet të fitohen edhe shumica e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve që përfaqësojnë komunitetet jo-shumicë në RMV, dhe
- » **Kompetencat:** Avokati i Popullit është i ngarkuar me përgjegjësi shtesë në lidhje me mbrojtjen e parimit të mos-diskriminimit dhe përfaqësimin e drejtë dhe të duhur të komuniteteve brenda institucioneve shtetërore dhe njësie të vetëqeverisjes lokale.

Me ligji për Avokatin e Popullit¹⁴⁰ në mënyrë plotësuese shtjellohen dispozitat kushtetuese.

140 Shih: *Ligji për avokatin e popullit*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LIX, nr.: 60, Shkup, 22.9.2003, f. 9-14.

4.5. KOMISIONI PËR PARANDALIMIN DHE MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Ligji për *Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi*¹⁴¹ paraqet kornizën e përgjithshme në lidhje me mbrojtjen nga diskriminimi në Republikën e Maqedonisë së Veriut, duke siguruar parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi për personat juridikë dhe personat fizikë, pavarësisht nga seksi, raca, ngjyra e lëkurës, gjinia, përkatësia e grupit të marginalizuar, origjina etnike, gjuha, shtetësia, prejardhja shoqërore, besimet, arsimi, përkatësia politike, statusi personal ose shoqëror, pengesa mendore ose fizike, moshë, gjendja familjare ose martesore, statusi i pronës, gjendja shëndetësore ose çfarëdo baze tjetër e parashikuar me ligj ose një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar, përfshirë fenë dhe besimet fetare (neni 3).

Zbatimi i ligjit qëndron në kompetencat e Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili, sipas nenit 16, është organ i pavarur dhe autonom, i cili vepron në përputhje me kompetencat e përcaktuara me ligj dhe ka cilësinë e personi juridik. Sipas nenit 17, Komisioni përbëhet nga shtatë anëtarë, të cilët emërohen nga Kuvendi i RMV-së me mandat pesëvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.

141 *Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LXVI, nr.: 50, op.cit.

SHQYRTIME PËRFUNDIMTARE

SHQYRTIME PËRFUNDIMTARE

Shpallja e pavarësisë së RMV-së nga ish republikat e tjera jugosllave dhe formimi i saj si shtet i pavarur, sovran dhe demokratik arriti qëllimin kombëtar të maqedonasve dhe qytetarëve të tjerë që jetojnë në territorin e shtetit për të krijuar shtetin e tyre. Pavarësia e shtetit, ndërpreu periudhën socialiste duke shënuar fillimin e zhvillimit të një rendi të ri demokratik me institucione të reja politike dhe vlera të reja demokratike. Këto procese u zhvilluan gradualisht, përmes një "tranzicioni demokratik" që gjithashtu ndikoi në mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe lirive të njeriut.

Në dallim nga periudha e mëparshme, të drejtat dhe liritë e njeriut filluan të rregullohen në mënyrë autentike duke zbatuar standardet përkatëse të njohura të Europës Perëndimore. Këto standarde u përfshinë në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut, e cila dha një frymë të re në çështjet që lidhen me statusin dhe pozitën e organizatave fetare, si dhe garantitë për ushtrimin e lirive dhe të drejtave fetare.

Me këtë rend të ri kushtetues, juridik dhe politik, Republika e Maqedonisë së Veriut duhej t'u përgjigjej sfidave të epokës së re. Lidhur me marrëdhëniet me organizatat fetare dhe garantitë në lidhje me të drejtat dhe liritë fetare, modeli i Maqedonisë së Veriut mbështetet si në standardet ndërkombëtare të Europës Perëndimore, po ashtu edhe në traditat e shumicës së popullsisë, të lidhur me Krishterimin Ortodoks. Përveç traditave të shumicës, Maqedonia e Veriut merr parasysh pluralizmin fetar si bazë për krijimin e identitetit kombëtar të shtetit. Sfidat për modelin maqedonas në marrëdhëniet me organizatat fetare dhe të drejtat dhe liritë e garantuara fetare lidhej drejtpërdrejt me aftësinë e faktorëve shtetërorë për të gjetur një ekuilibër të përshtatshëm midis elementeve të ndryshme. Modeli maqedonas i shekullarizmit ka krijuar marrëdhënie specifike midis vetë organizatave fetare, si dhe midis organizatave fetare dhe shtetit, duke siguruar ushtrimin e papenguar të lirisë së fesë në vend.

Modeli laik i marrëdhënieve midis shtetit dhe organizatave fetare nuk bazohet vetëm në vlerat që burojnë nga trashëgimia e Evropës Perëndimore, por edhe nga marrëdhëniet tradicionale të karakterit autokton.

Parimi maqedonas i shekullarizmit është parim kushtetues që, drejtpërdrejt dhe në mënyrë të qartë, përcakton kufirin e mosndërhyrjes së institucioneve dhe organeve shtetërore në kompetencat e organizatave fetare, dhe anasjelltas, ndalon përfshirjen e organizatave fetare në çështjet që janë në kompetencë të shtetit.

Kushtetuta e RMV-së siguron garanci për ushtrimin e lirive dhe të drejtave fetare të qytetarëve bazuar në standardet universale dhe euro-perëndimore.

Kështu, traditat, zakonet dhe rregullat e pashkruara të sjelljes së shumicës së popullsisë të cilët janë të krishterë ortodoksë dhe të lidhur kështu me Perandorinë Bizantine, Kisha Ortodokse, si dhe trashëgimia e saj historike dhe shpirtërore, janë kryesore për përcaktimin e modelit të laicitetit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Natyrisht, në thelbin e këtij modeli autokton, shumësia e peizazhit fetar sigurohet duke përcaktuar dhe mbrojtur garancitë për aktivitetet e organizatave të tjera fetare: Bashkësisë Islame, Kishës Katolike, kishave Protestante, Bashkësisë Hebraike, dhe organizatave të tjera fetare.

Duke marrë parasysh rrethanat historike dhe politike, si dhe Kushtetutën e sotme, modeli maqedonas i marrëdhënieve me organizatat fetare mund të përcaktohet si diçka midis modelit të fesë shtetërore dhe modelit të sekularizmit, sepse, në kuptimin historiko-shtetformues dhe simbolik, Kisha Ortodokse është e ndarë nga organizatat e tjera fetare, ndërsa korpusi themelor i të drejtave, si dhe garancitë për lirinë e fesë, janë në nivelin e standardeve demokratike europiane.

Ky fakt konfirmohet edhe nga hipoteza e paraqitur në fillim të këtij manuali, sipas së cilës karakteri demokratik i Republikës së Maqedonisë së Veriut mund të përcaktohet bazuar në zbatimin praktik të standardeve në lidhje me pozicionin e shtetit ndaj feve, si dhe bazuar në shkallën e zbatimit të lirisë së fesë. Theksimi i një feje mbi të tjerat nuk nënkupton domosdoshmërisht ndonjë deficit demokratik të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

LITERATURA E SHFRYTËZUAR

- » Bartłomiej Kaminski, *The Collapse Of State Socialism*, Princeton University Press, Princeton, New Jersey, 1991.
- » *Bill of rights*, (archives.gov), 7.3.2018.
- » Blandine Chelini-Pont, *Religion and Society in Europe*, Conference: “Law and Religion in Transitional Societies”, Norway, 2006.
- » Brad K. Blitz, *War and change in the Balkans: nationalism, conflict and cooperation*, глава 9 Andrew Rosos, *Disintegration of Yugoslavia: Macedonia's Independence and Stability in the Balkans*, Cambridge University Press, Cambridge, 2006.
- » Carole Rogel, *The Breakup of Yugoslavia and its Aftermath*, Greenwood Press, 2004.
- » *Declaration of Independence*, (archives.gov), 7.3.2018.
- » *Declaration of the Rights of Man and of the Citizen*, (hrcr.org), 7.3.2018.
- » Gerhard Robbers, *Encyclopedia of World Constitutions*, Igor Spirovski (автор), *Macedonia*, VB Hermitage.
- » Gordana Siljanovska, *Democracy in Multiethnic and Multicultural Society: between Demos and Ethnos*, Macedonia in Globalisation, Public Scholarly Publications, New York, 2004.
- » Henry H. Perritt, *The road to independence for Kosovo: a chronicle of the Ahtisaari plan*, Cambridge University Press, Cambridge, 2010.
- » James T. Richardson Religion, *Constitutional Courts, and Democracy in Former Communist Countries*, The Annals of the American Academy, January 2006.
- » Jeremy Gunn, *Religion and Societies in Transition*, Conference: “Law and Religion in Transitional Societies”, Norway, 2006.
- » John Meyendorff, *The Byzantine Legacy in the Orthodox Church*, St Vladimir's Seminary Press, Crestwood-New York, 1982.
- » Martin Fitzpatrick et al., *The Enlightenment World*, Routledge, New York, 2004.
- » Micheline Ishay, *The History of Human Rights: From Ancient Times to the Globalization Era*, University of California Press, 2008.

- » Mile Bogović, *Država i crkva u srpskom pravoslavlju*, Centar za politikološka istraživanja (cpi.hr), 7.3.2018.
- » Pedro Ramet, *Eastern Christianity and Politics in the Twentieth Century*, Duke University Press, 1988.
- » Petar Radan, *Break-up of Yugoslavia and International Law*, Routledge, 21.9.2001.
- » Philip Schaff, David Schley Schaff, *History of the Christian church*, Charles Scribner's Sons, New York, 1910.
- » Sabine C. Carey et.all., *The Politics of Human Rights: The Quest for Dignity*, Cambridge University Press, Cambridge, 2010.
- » Stathis N. Kalyvas, *Religion and Democratization: Belgium and Algeria*, Estudio/ Working Paper 107, 1997.
- » *The Renaissance, A Very Short Introduction*, Oxford University Press, Oxford, 2006.

AKTET

- » *Amendamentet IV, V, VI, VII, VIII, IX, X, XI, XII, XIII, XIV, XV, XVI, XVII dhe XVIII të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LVII, nr.: 91, Shkup, 20.11.2001.
- » Byroja e zhvillimit të arsimit të Republikës së Maqedonisë, *Programi mësimor i lëndës së etikës së religjionit për klasën V të arsimit fillor tetëvjeçar* (bro.gov.mk), 2.2.2012.
- » *Deklaratë për Njohjen Ndërkombëtare të Republikës së Maqedonisë*, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, nr 08-5099, 19.12.1991.
- » *Deklaratë për Njohjen Ndërkombëtare të Republikës së Maqedonisë*, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, nr.: 08-5099, 19.12.1991.
- » *Deklarata e Sovranitetit të Republikës Socialiste të Maqedonisë*, Kuvendi i Republikës Socialiste të Maqedonisë, nr.: 08-220-1.
- » *Deklarata për shprehjen e vullnetit plebishitar të qytetarëve për shtet sovran dhe të pavarur të Maqedonisë*, Kuvendi i Republikës Socialiste të Maqedonisë, nr.: 08-3786, 17.9.1991.
- » *Deklarata për Mbështetjen e Autoqefales së Kishës Ortodokse Maqedonase*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LX, nr.: 4, Shkup, 2.2.2004.
- » *Rregullorja e punës e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë*, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë, Shkup, (ustavensud.mk), 10.3.2018.

- » *Ligji për Bashkësitë Fetare, dhe Grupet religjioze*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LIII, nr.: 35, Shkup, 23.7.1997.
- » *Ligji për Institucionet e Arsimit të Lartë të Bashkësive Fetare*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LXIV, nr.: 81, Shkup, 7.7.2008.
- » *Ligji për Arsimin e Lartë*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LXIV, nr.: 35, Shkup, 14.3.2008.
- » *Ligji për Punë të Brendshme*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LXV, nr.: 92, Shkup, 24.7.2009.
- » *Ligji për Denacionalizimin*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LIV, nr.: 20, 29.4.1998.
- » *Ligji për shoqatat dhe fondacionet*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LXVI, nr.: 52, Shkup, 16.4.2010.
- » *Ligji për Shoqatat e Qytetarëve dhe Fondacionet*, Gazeta Zyrtare e Republikës, viti: LIV, nr.: 31, Shkup, 2.7.1998.
- » *Ligji për Ekzekutimin e Sankcioneve*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LXII, nr.: 2, Shkup, 9.1.2006.
- » *Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për denacionalizimin*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LVI, nr.: 31, 20.4.2000.
- » *Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për mbrojtje*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LXII, nr.: 58, Shkup, 11.5.2006.
- » *Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për festat në Republikën e Maqedonisë*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, viti: LXIII, nr.: 18, Shkup, 15.2.2007.
- » *Ligji për Prokurorinë Publike*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LXIII, nr.: 150, Shkup, 12.12.2007.
- » *Ligji për Kulturë*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LIX, nr.: 49, Shkup, 25.7.2003.
- » *Ligji për Avokatin e Popullit*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LIX, nr.: 60, Shkup, 22.9.2003.
- » *Ligji për Mbrojtje*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LVII, nr.: 42, Shkup, 1.6.2001.
- » *Ligji për Mbrojtjen*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: XLVIII, nr.: 8, Shkup, 15.2.1992, f.: 85-96.

- » *Ligji për organizimin dhe funksionimin e organeve të administratës shtetërore*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LVI, nr.: 58, Shkup, 21.7.2000.
- » *Ligji për arsimin fillor*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LI, nr.: 44, Shkup, 20 shtator 1995.
- » *Ligji për arsimin fillor*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LXIV, nr.: 103, Shkup, 19.8.2008.
- » *Ligji për Partitë Politike*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LX, nr.: 76, Shkup, 27.10.2004.
- » *Ligji për statusin juridik të bashkësive fetare*, Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste të Maqedonisë, viti: XXXIII, nr.: 39, Shkup, 14.11.1977, f.: 860-862.
- » *Ligji për statusin juridik të kishës, bashkësisë fetare dhe grupit religjioz*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LXIII, nr.: 113, Shkup, 20.9.2007.
- » *Ligji për festat e Republikës së Maqedonisë së Veriut*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: VXIII, nr.: 18, Shkup, 15.2.2007.
- » *Ligji për festat e Republikës së Maqedonisë*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LIV, nr.: 21, Shkup, 8.5.1998.
- » *Ligji për marrëdhënien e punës*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LXVI, nr.: 158, Shkup, 9.12.2010.
- » *Ligji për Mbrojtjen Sociale*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LXV, nr.: 79, Shkup, 24.6.2009.
- » *Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë: viti: LXVI, nr.: 50, Shkup, 13.4.2010.
- » *Ligji për arsimin e mesëm*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: LVIII, nr.: 52, Shkup, 10.7.2002.
- » *Ligji për Gjykatat*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë,, viti: LXII, nr.: 58, Shkup, 11.5.2006.
- » *Kodi Penal*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë: viti: LII, nr.: 37, Shkup, 29.7.1996.
- » *Vendim për shpalljen e amendamenteve LXXXII - LXXXV të Kushtetutës së Republikës Socialiste të Maqedonisë, Amendamentet e Kushtetutës së Republikës Socialiste të Maqedonisë*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, viti: XLVII, nr: 27, Shkup, 11.6.1991.

- » *Propozim për miratimin e ligjit për bashkësitë fetare dhe grupet religjioze, arsyet e miratimit të ligjit*, Arkivi i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë 313/1, 31.1.1997.
- » *Marrëveshja Kornizë*, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Sekretariati për Zbatimin e Marrëveshjes Kornizë (siofa.gov.mk), 7.3.2018.
- » *Rezoluta e Sinodit të Shenjtë të Kryepeshkopatës së Kishës Ortodokse Maqedonase*, 12.11.2004, (mpc.org.mk), 10.3.2018.
- » *Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut*, (un.org), 7.3.2018.
- » *Rregullorja për themelimin e Komisionit Shtetëror për Çështje Fetare*, Gazeta Zyrtare e Republikës Federale Popullore të Jugosllavisë, viti: I, nr.: 62, Beograd, 21.8.1945.
- » *Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, viti: XLVII, nr.: 52, Shkup, 1991, f.: 805-815.

Modeli maqedonas i shekullarizmit bazohet në shekullarizimin institucional, si dhe në karakterin jo-teokratik të shtetit. Klerikët nuk mund të jenë udhëheqës të shtetit dhe shteti nuk mund të ndërhyjë në zgjedhjen e klerikëve ose punët e brendshme të organizatave fetare.

Por, duhet të kemi parasysh se shekullarizmi nuk mund t'u imponohet qytetarëve ose të formojë ndjenjat e tyre të brendshme në lidhje me organizatat dhe grupeve religjioze. Ndarja kishës nga pushteti politik është e garantuar me Kushtetutë dhe e përpunuar hollësisht në ligjet përkatëse, megjithatë, ndjenjat personale dhe përkatësia fetare e qytetarëve vështirë se mund të modelohen brenda kufijve të atyre dispozitave ligjore.

Ndjenjat dhe përkatësia ndaj organizatave fetare ndikohen shumë nga mjediset e jetesës së qytetarëve, me rregullat dhe kodet e tyre të pashkruara, sesa nga dispozitat ligjore. Zakonet dhe shprehitë, traditat dhe konventat mbesin faktorë të fuqishëm që shpeshherë dinë të rrëshqasin nga shekullarizmi dhe të ndërhyjnë duke tundur marrëdhëniet e përcaktuara me ligj.

